

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5447
E martë, 10 prill 2018
çmimi 0.40 €

Një dekadë Kushtetutë

Në dhjetëvjetorin e miratimit të Kushtetutës së Kosovës liderët institucionalë kanë theksuar se, pas çlirimit të Kosovës dhe shpalljes së Pavarësisë, themelimi i Kushtetutës së vendit është ndër datat më të rëndësishme të kalendarit tonë shtetëror



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de



Sot me 10 prill 2018, në ora 11:00, në varrezat e fsh. Greme, mbahen homazhe në përkujtim të 9 vjetorit të ndarjes

nga jeta të luftëtarit e ushtarit të tri ushtrive, Ushtria Çlirimtare e Kosovës, UÇPMB dhe Ushtria Çlirimtare Kombëtare, të pavdekshmit Shaban Viqa - Bac!



FLET PËR "EPOKËN E RE", ABELARD TAHIRI

Kosova nuk ka më nevojë për EULEX-in

- Sistemi i drejtësisë nuk ka nevojë për një mision ekzekutiv të EULEX-it

Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, ka thënë se gjatë këtyre shtatë muajve ka pasur angazhim të madh për sundim të ligjit dhe luftën kundër korrupsionit e krimin të organizuar. Si rezultat i kësaj dinamike, ai ka thënë se janë përm-bushur obligimet që dalin nga Agjenda e

Reformave Evropiane, e cila do të ndikojë në procesin e liberalizimit të vizave dhe do ta fuqizojë vendosmërinë për luftimin e dukurive negative. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Tahiri ka vlerësuar se sistemi i drejtësisë ka kapacitete për ta bërë punën në

përpunje të ligjeve, pa pasur nevojë për një mision ekzekutiv të EULEX-it. Ai ka folur edhe për Gjykatën Speciale, për të cilën ka thënë se do të angazhohet që ky proces të përmbyllet me siguri të plotë juridike, që të dalë në shesh e vërteta për luftën e pastër të UÇK-së

LIDERËT INSTITUCIONALE KANË BËRË HOMAZHE TE VARREZAT E DËSHMORËVE NË KOSHARE

Beteja e Koshares dëshmoi unitetin e luftëtarëve shqiptarë



Beteja e Koshares ka dëshmuar unitetin e luftëtarëve shqiptarë dhe fazën më të lartë të rezistencës së UÇK-së. Kështu

është thënë në manifestimin tradicional "Ditët e shqipes", i cili është organizuar për nder të betejës së Koshares. Në 19-

vjetorin e kësaj beteje ish-udhëheqësit e UÇK-së e kanë vlerësuar lart ndikimin e kësaj beteje për çlirimin e Kosovës



SBASHK-u: Greva në arsim do të fillojë më 13 prill

RENOVA
Maqedoni
Xhepçisht-Tetovë
Çarëz-Ferizaj
PUTZ
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009; +389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GRUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

SatStyro
Mushnikovë-Prizren-Kosovë
Product of EPS and XPS
Mob.: +377(0) 44 506 815
Tel&Fax: +381(0) 29 246 030
e-mail: sat_styro@yahoo.com
www.satstyro.com

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302.
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

AKTUALE

MOSBINDJA QYTETARE F. 6

Nga Blerta HAXHIAJ



SAMI LUSHTAKU: PDK-ja PO HYN E UNIFIKUAR NË ZGJEDHJET E BRENDSHME F. 10

FATURA E MBETURINAVE, KUSHT PËR REGJISTRIM TË VETURAVE F. 10

EKONOMI

PRODHIMTARIA VENDORE, NËN HIJEN E IMPORTIT F. 18

VEND I VARFËR, POR ME SHUMË DITË PUSHIMI F. 18

SPORT

POPULLIT T'I JAPËSH AQ SA KE E ÇKA MUNDËSH, JO T'I MARRËSH MË SHUMË SESA I JEP F. 15

Merkeli sërish takon Vuçiqin, temë bisedimesh edhe Kosova

Kabineti i kancelares gjermane ka njoftuar se më 13 prill Angela Merkel pret për vizitë sërish kreun e shtetit serb, Aleksander Vuçiq, i cili pritet të bisedojë edhe për një zgjidhje të konfliktit disavjeçar me Kosovën



BERLIN, 9 PRILL - Shpeshtohen vizitat e presidentit serb, Aleksandar Vuçiq, në Berlin. Javën e ardhshme ai pritet sërish nga kancelarja Merkel. Edhe në shkurt presidenti Vuçiq ishte në Berlin dhe të premtën ai ka biseduar në telefon me Merkelin për çështjen e Kosovës.

Më 13 prill kancelarja gjermane, Angela Merkel, pret për vizitë sërish presidentin e Serbisë, Aleksander Vuçiq, ka njoftuar zyra e kancelares gjermane. Në qendër të vizitës janë bisedimet për marrëdhëniet

bilaterale, por edhe çështjet rajonale. Vuçiqi pritet të bisedojë me Merkelin për një zgjidhje të konfliktit dhjetëvjeçar me Kosovën. Presidenti serb dhe kancelarja Merkel do të kenë një drekë të përbashkët të premtën.

Në këtë kuadër presidenti serb ka biseduar në telefon me kancelaren Merkel të premtën, bëjnë të ditur mediet, edhe për zgjidhjen e konfliktit me Kosovën. Vuçiqi ka bërë me dije se do të bëjë propozime për një zgjidhje të qëndrueshme në marrëdhëniet me

Kosovën. Por, dihet se Serbia mund të afrohet më tej me Brukselin vetëm nëse i jep përfundimisht zgjidhje konfliktit me Kosovën. Kosova e njohur nga më shumë se 110 shtete, nuk njihet nga disa vende të BE-së. Anëtarët e saj, si Spanja, Rumania apo Qiproja, kanë kërcënuar madje bllokimin e samitit të Ballkanit Perëndimor të Presidencës bullgare në maj në Sofje, nëse Kosova ftohet si shtet i barabartë. Edhe Greqia dhe Sllovakia nuk e pranojnë njohjen e Kosovës si shtet i pavarur.

LAJME SHKURT

Basha mbledh grupin parlamentar

TIRANË, 9 PRILL - Kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha, ka mbledhur të hënën në mbrëmje grupin parlamentar në selinë e PD-së. Po ashtu, bëhet me dije se në këtë mbledhje do të merren një sërë vendimesh të rëndësishme që lidhen me protestat në kuadër të thirrjes për mosbindje civile, por edhe takimit me bizneset e vogla.



Një ditë më parë, kryetari i PD-së Lulzim Basha, e ka cilësuar veprim qesharak hapin e Policisë së Shtetit për procedimin e tij dhe deputetëve të opozitës që morën pjesë në protestën e së enjtes. Basha tha se kishte për nder që procedohej penalisht bashkë me qytetarët që jemi ngritur në protestë për një të drejtë legjitime dhe, siç tha Basha, për t'i mbrojtur 11 kuksianët e arrestuar padrejtësisht dhe që mbahen padrejtësisht në qelitë e burgut. Nga ana tjetër, lideri demokrat paralajmëroi se beteja do të vazhdojë dhe se askush prej të proceduarve nuk frikësohet apo prapset nga ky veprim qesharak "i hetuesisë politike, Rama-Marku". Kujtojmë se dita e sotme është pushim për institucionet dhe aktivitetet politike, por Basha ka shfrytëzuar këtë ditë për ta zhvilluar mbledhjen me deputetët demokratë.

Kotzias nuk do të vijë sot në Tiranë

TIRANË, 9 PRILL - Ministri i Jashtëm i Greqisë, Nikos Kotzias, nuk do të vijë sot (e martë) në Tiranë. Edhe pse në mediet greke u fol se shefi i diplomacisë helene do të vizitonte për të dytën herë brenda pak ditësh Shqipërinë, kjo hipotezë rrëzohet.



Burime zyrtare pranë Ministrisë së Jashtme thanë se Kotzias nuk do të ketë një vizitë në Tiranë sot (e martë). Sipas medieve greke, ministri i Jashtëm grek do të jetë në Shkup sot (e martë). Vizita e Kotzias u konsiderua nga mediet greke si zëvendësim i vizitës së munguar të kryeministrit grek Tsipras, vizitë e cila u shty, edhe pse ishte e parashikuar për Pashkët Ortodokse. Në vijim të zgjidhjes së problemeve shumëpalëshe, sidomos çështjes së detit, negociatat kanë ngecur në miratimin e ekipeve negociatore.


Zaev: Ligji për gjuhët nuk paraqet kurrfarë dhimbje

SHKUP, 9 PRILL - Ligji për gjuhët paraqet rrumbullakim të Marrëveshjes së Ohrit dhe kjo do të ndikojë në drejtëm të miratimit të marrëdhënieve ndëretnike. Kështu tha kryeministri i Maqedonisë, Zoran Zaev, derisa iu përgjigj kritikave të opozitës në drejtëm të procedurës së miratimit të Ligjit në fjalë. Ai tha se Ligji për gjuhët nuk paraqet kurrfarë dhimbje. "Aspekti i fundit i relaksimit të marrëdhënieve ndëretnike, duke i vendosur ato në kuadër të konceptit të ofruar nga ideja e një shoqërie për të gjithë, është plotësimi i detyrimeve

legjislative të Marrëveshjes Kornizë të Ohrit. Këtë rrumbullakim e bën pikërisht Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve si një e drejtë kushtetuese e paplotësuar e bashkësive të tjera etnike në vend. Nëse lejojmë të jetojë do të shohim se nuk paraqet kurrfarë dhimbje por, në fakt, do t'u mundësojë qytetarëve ta ndiejnë shtetin si të tyre sepse, përveç detyrimeve, u lejohen edhe të drejtat që çdo qytetar i shtetit duhet t'i ketë. Nga ky aspekt jam i bindur se ajo që po krijohet në Republikën e Maqedonisë është një përfitim i përhershëm që do ta

bëjë vendin nga i cili të gjithë do të jemi krenarë", ka thënë Zaev.

Ndërkaq grupi parlamentar i VMRO-DPMNE-së ka dorëzuar mocionin për votëbesimin e Qeverisë. Kryetari i parlamentit, Talat Xhaferi, i ka njoftuar deputetët se sot (e martë) do ta caktojë seancën për votëbesimin e Qeverisë për nesër (e mërkurë). Debat i pastaj duhet të zgjasë deri në mesnatë, pastaj duhet të votohet të njëjtën ditë kur edhe ka filluar. Për të kaluar mocioni i mosbesimit duhen 61 vota të deputetëve. VMRO-ja ka 49 mandate




deputetësh, nga gjithsej 51 që i siguroi gjatë zgjedhjeve parlamentare të 2016-s. Dy deputetë, Çedomir Sezdovski dhe Amdi

Bajram, lëshuan grupin e VMRO-DPMNE-së për t'i përkrahur vendimet e shumicës parlamentare.

Republika e Kosovës ka shënuar Ditën e Kushtetutës

Një dekadë Kushtetutë

Në dhjetëvjetorin e miratimit të Kushtetutës së Kosovës, liderët institucionalë kanë theksuar se, pas çlirimit të Kosovës dhe shpalljes së Pavarësisë, themelimi i Kushtetutës së vendit është ndër datat më të rëndësishme të kalendarit tonë shtetëror. Kurse njohësit e çështjeve kushtetuese e kanë shprehur nevojën e ndryshimit të këtij dokumenti

**EPOKA
ERE**

Muhamet KOÇI

PRISHTINË, 9 PRILL - Kushtetuta e Republikës së Kosovës të hënën ka mbushur dekadën e parë. Ditën e Kushtetutës liderët institucionalë e kanë vlerësuar si datën më të rëndësishmen për vendin, pas asaj të çlirimit dhe të shpalljes së pavarësisë. Akti më i lartë juridik i vendit, i cili e përcakton Kosovën shtet të pavarur dhe sovran, sipas liderëve, gjatë kësaj kohe ka pasur edhe sfidat e veta. Megjithatë, presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, është zotuar se institucionet e Kosovës asnjëherë nuk do të ndalen së punuari për ta forcuar shtetin duke respektuar të drejtat e liritë e çdo qytetari. "Kushtetuta e Republikës së Kosovës sot shënon dekadën e parë. Si udhërrëfyes për krijimin dhe forcimin e shtetit, ajo pasqyron më së miri përpjekjet shekullore për liri, barazi e drejtësi dhe dëshmon vendosmërinë për të ndërtuar një të ardhme të përbashkët në paqe të qëndrueshme. Asnjëherë nuk do të ndalemi së punuari për të forcuar shtetin, duke respektuar të drejtat e liritë e çdo qytetari dhe duke garantuar barazinë e tyre para ligjit", ka thënë Thaçi.

Ndërkaq kryeparlamentari Kadri Veseli ka thënë se në këta

dhjetë vjet Kushtetuta e Republikës së Kosovës ka arritur t'i jetësojë detyrat dhe funksionet themelore të mekanizmeve të shtetit tonë duke arritur qëllimin e vet thelbësor me sukses. "Nëpërmjet saj kemi dëshmuar mundësitë tona duke ushtruar sovranitetin dhe integritetin e vendit tonë. Kushtetuta e Republikës së Kosovës përmban standardet më të larta të të drejtave dhe zbatueshmërisë së plotë të saj", ka thënë Veseli në urimin e tij për dhjetëvjetorin e Kushtetutës.

Kurse kryeministri Ramush Haradinaj në urimin e tij për Ditën e Kushtetutës ka theksuar se një dekadë më parë, përmes këtij dokumenti u vulos Kosova jonë si vend i pavarur. "Pas çlirimit të Kosovës, shpalljes së Pavarësisë, themelimit i Kushtetutës së vendit është ndër datat më të rëndësishme të kalendarit tonë shtetëror. Më 9 prill të vitit 2008 Kosova vendosi themelet e saj të konsolidimit si shtet, duke e funksionalizuar aktin më të lartë

juridik, Kushtetutën e vet. Një dekadë më parë përmes këtij dokumenti u vulos Kosova jonë si vend i pavarur, me qytetarë të lirë, me të drejta të barabarta për secilin, në frymën e pakufizuar demokratike. Dekada e parë e Kushtetutës së vendit, krahas qenësimit tonë si shtet juridik, ka përjetuar edhe sfidat e saj. Këto sfida na tregojnë edhe vlerat tona demokratike si shoqëri kur ne kemi pranuar këto parime kushtetuese si parime udhëheqëse të Kosovës", ka vlerësuar Haradinaj.

Me rastin e dhjetëvjetorit të miratimit të Kushtetutës, edhe zëvendës kryeministri, njëherësh edhe lider i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ka dhënë mendimin e tij. "Një dekadë më parë Kosova miratoi aktin më të lartë juridik të vendit, Kushtetutën. Kushtetuta e Republikës së Kosovës ngërthen në vete përpjekjet tona shekullore për shtet e barazi ligjore. Në këta 10 vjet Kushtetuta disa herë është sfiduar edhe nga vetë udhëheqësit e institucioneve. Angazhimi i institucioneve të Kosovës duhet të jetë gjithmonë në funksion të realizimit të synimeve të deklaruara në Kushtetutën e Kosovës!", ka deklaruar Limaj.

Kushtetuta duhet të ndryshohet

Në dhjetëvjetorin e miratimit të Kushtetutës së Kosovës, njohësit e të drejtës kushtetuese kanë shprehur nevojën e ndryshimit të aktit më të lartë juridik dhe politik të vendit. Ish-kryetari i Komisionit për hartimin e Kushtetutës së Kosovës, Hajredin Kuçi, ka thënë se ka ardhur koha që Kushtetuta të pësojë ndryshime aty ku ka nevojë. "Gjatë kësaj periudhe Kushtetuta është sfiduar dhe natyrisht sfida e parë ka ardhur nga vetë shtrirja e saj në territorin e Republikës së Kosovës. Pastaj është sfiduar nga individët e institucioneve të cilët nuk e kanë respektuar në plotësi qoftë në synimin e saj apo edhe normën juridike të saj. Do të thosha, sa herë që bëhet një përvjetor, ka arsye të bëhet edhe një përditësim i saj. Unë them gjithmonë se jeta është më evolutive se norma juridike, andaj jeta në Kosovë ka evoluar në dhjetë vjetet e fundit. Qëllimet tona politike që kanë qenë në atë kohë janë

realizuar", ka deklaruar Kuçi. Mendim të njëjtë ka shprehur edhe profesori universitar i së Drejtës, Flamur Hyseni. Ai ka thënë për "Epokën e re" se Kushtetuta e Kosovës ka nevojë të plotësohet me disa kapituj në të ardhmen. "Disa formula kushtetuese kanë qenë si kushtëzime për të ekzistuar shteti i Kosovës, sepse kjo Kushtetutë ka pasur rol dhe mision historik, bërjen funksional të shtetit me të gjitha institucionet kryesore shtetërore. Këto kushtëzime, me kalimin e kohës, e humbasin rëndësinë e tyre dhe ndodhë ndryshimi. Kjo Kushtetutë në dhjetë vjetet e ardhshëm ka nevojë të plotësohet me kapituj të rinj për konstitucionalizimin e partive politike, për integritet evropiane dhe anëtarësimin në NATO. Ndërsa duhet të ndryshohet sa i përket mënyrës së zgjedhjes së presidentit. Presidentit duhet të zgjedhet drejtpërdrejt nga populli", ka thënë Hyseni.

SBASHK-u: Greva në arsim do të fillojë më 13 prill

PRISHTINË, 9 PRILL - Sindikata e Bashkuar e Arsimit, e Shkencës dhe e Kulturës e Republikës së Kosovës (SBASHK) ka bërë me dije se sot (e martë) do të vazh-

dojë të mbajë proces i rregullt mësimor, ndërkaq greva në arsim do të jetë nga data 13 prill. Kështu ka thënë për "Telegraf"-in kryetari i kësaj sindikate,

Rahman Jasharaj. "Me rezolutën që e ka nxjerrë Kongresi më 24 shkurt, greva është paraparë të mbahet nga 13 prilli e tutje", ka thënë Jasharaj. Ai ka

theksuar se presin që prej të martës e deri më 13 prill të kenë takime dhe që Qeveria të reflektojë karshi kërkesave të SBASHK-ut.



Flet për "Epokën e re", Abelard Tahiri

Kosova nuk ka më n

- Sistemi i drejtësisë nuk ka nevojë për një mision ekzekutiv të EULEX-it

Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, ka thënë se gjatë këtyre shtatë muajve ka pasur një angazhim të madh për sundim të ligjit dhe në luftën kundër korrupsionit e krimit të organizuar. Si rezultat i kësaj dinamike ai ka thënë se janë përmbushur obligimet që dalin nga Agjenda e Reformave Evropiane, e cila do të ndikojë në procesin e për luftimin e dukurive negative. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Tahiri ka vlerësuar se sistemi i drejtësisë ka kapacitete për ta bërë punën në përputhje të ligjeve, pa pasur nevojë për një mision ekzekutiv të EULEX-it. Ai ka folur edhe për Gjykatën Speciale, për të cilën ka thënë se do të angazhohet që ky proces të përmbyllet me siguri të plotë juridike që të dalë në shesh e vërteta për luftën e pastër të UÇK-së

EPOKA E RE **Shqipëri HETEMI**

PRISHTINË, 9 PRILL -

"Epoka e re": Z. Tahiri, Ministria e Drejtësisë sa ka arritur ta përmbushë legjislacionin e kërkuar nga Agjenda e Reformave Evropiane, kur dihet se lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar është një sfidë dhe proces i përhershëm, sidomos për liberalizimin e vizave?

Tahiri: Në radhë të parë, sundimi i ligjit si dhe lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar jo vetëm në Kosovë, por çdo kund, janë aspekte që kanë të bëjnë me integritetin e shoqërisë dhe integritetin e institucioneve prandaj, si të tilla, të njëjtat paraqesin procese të vazhdueshme mbi të cilat institucionet tona kanë bërë dhe do të vazhdojnë të bëjnë përpjekje. Kjo natyrisht se reflektohet edhe në masa të matshme dhe konkrete siç është rasti me indikatorët për liberalizimin e vizave. Në këtë drejtim, ka dy komponentë vendimtarë. Së pari, aspekti i politikëbërjes; së dyti, aspekti i zbatimit të ligjit. Në aspektin e politikëbërjes, që është përgjegjësi e drejtpërdrejtë e ministrisë që unë drejtoj, mund të konfirmoj me përgjegjësi të plotë se një dinamikë e jashtëzakonshme e angazhimit ka ndodhur gjatë këtyre shtatë muajve si rezultat i së cilës tashmë kemi përmbushur obligimet tona që dalin nga Agjenda e Reformave Evropiane. Pjesë e kësaj agjende kanë qenë rishikimi dhe miratimi i tri politikave legjislative që ndërliiden me fuqizimin e kapaciteteve dhe bazës ligjore për luftimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar. Në këtë drejtim ne kemi hartuar projektligjin për

Prokurorin e Shtetit dhe Projektligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit për ushtrimin e funksionit publik, të cilat projektligje tashmë janë miratuar përfundimisht nga Kuvendi i Republikës së Kosovës si dhe kemi hartuar edhe një concept-dokument për suspendimin e zyrtarëve publikë në rast të ngritjes së aktakuzave për korrupsion apo keqpërdorim të detyrës zyrtare, rekomandimet e të cilit i kemi përfshirë në ndryshimet që kanë zënë vend në Kodin Penal dhe ato që janë duke zënë vend në ndryshimet në Kodin e Procedurës Penale. Përmbushja e kësaj agjende do të reflektojë edhe në raportin për vendin edhe në forcimin e garancive në rrugën evropiane të Kosovës, veçmas do të ndikojë në procesin e liberalizimit të vizave sepse këto ndryshime legjislative do të sjellin në një dimension të ri dhe shumë më të fuqishëm vendosmërinë e institucioneve të Republikës së Kosovës për luftimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar.

"Epoka e re": Ju keni deklaruar se 2018-a do të jetë vit i sundimit të ligjit. Sa jeni i kënaqur me punën e gjykatave dhe pagat që sot kanë gjyqtarët?

Tahiri: Në rrafshin politik, që nga fillimi, jam angazhuar që vitin 2018 të jetë vërtet një vit i sundimit të ligjit në kuptim të asaj që sundimi i ligjit të jetë tema qendrore e këtij mandati qeverisës nga shumë perspektiva që këtë e bëjnë të mundur. Në rrafshin institucional, kam ndërmarrë veprime konkrete që mbështesin këtë përcaktim, duke filluar nga rritja e buxhetit për Këshillin Gjyqësor dhe Këshillin Prokurorial të Kosovës, ku për herë të parë pas disa vjetësh buxheti për të dy këshillat është rritur bazuar

ekskluzivisht në kërkesat e tyre, gjë që do të mundësojë shtimin e numrit të gjykatësve, prokurorëve dhe bashkëpunëtorëve profesionalë, rrjedhimisht do të ndikojë në shqyrtimin më efikas të lëndëve nëpër gjykata dhe uljen e numrit të tyre. Ndryshimet në Ligjin për Prokurorin e Shtetit të miratuar tashmë do ta mundësojnë edhe rritjen e kapaciteteve në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës për të mundësuar efikasitet më të madh në çështjet që janë në mandatin e kësaj prokurorie. Një aspekt tjetër i rëndësishëm është edhe agjenda legjislative e vitit 2018, ku Ministria e Drejtësisë për këtë vit ka hartuar dhe është në proces të hartimit të 19 projektligjeve që paraqet ndërmarrësin më të madh ndonjëherë në rang të institucioneve të Republikës së Kosovës. Në mesin e këtyre projektligjeve ka të tilla që adresojnë luftimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar siç është Kodi Penal, Kodi i Procedurës Penale dhe Pakoja e Ligjeve Kundër Korrupsionit, pastaj projektligje që rregullojnë të drejtën pronësore, të përcjella edhe nga projekti më i madh legjislativ pas Kushtetutës, Kodi Civil i Republikës së Kosovës, si dhe projektligje që mundësojnë efikasitet, transparencë dhe llogaridhënie në sistemin gjyqësor dhe atë prokurorial, siç është Pakoja e Ligjeve të Gjyqësorit. Ajo çfarë vitin 2018 e bën një vit që temë qendrore ka fuqizimin e shtetit të së drejtës, është edhe reforma më e madhe e ndërmarrë ndonjëherë në fushën e drejtësisë, përkatësisht procesi i Rishikimit Funkcional të Sektorit të Sundimit të Ligjit, një proces jashtëzakonisht kompleks dhe gjithëpërfshirës, që synon të bëjë një vlerësim të



përgjithshëm të sistemit të drejtësisë dhe të gjitha komponentëve përbërëse të saj, në mënyrë që në fund të kësaj reforme të dalim me Strategjinë kombëtare për sundimin e ligjit, e cila do t'i përcaktojë dhe unifikojë parimet, legjislacionin dhe të ardhmen e zhvillimit të sistemit të drejtësisë në Republikën e Kosovës. Sa iu përket pagave të gjyqtarëve, kam qenë i angazhuar dhe vazhdoj ta mbështes idenë se pagat e gjyqtarëve dhe prokurorëve duhet të jenë të krahasueshme me ato të rajonit dhe më gjerë, sepse konsideroj se shpenzimet në këtë drejtim nuk janë shpenzime klasike, por investime për sistemin e drejtësisë që do të mundësojë efikasitet më të madh në punën e tyre.

Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe sipas kornizave të Gjykatës Kushtetuese

"Epoka e re": Sa ka arritur Ministria e Drejtësisë t'i funksionalizojë institucionet e drejtësisë në pjesën veriore për ta garantuar sundimin e ligjit në mbarë territorin e Republikës së Kosovës? A mund të themi se kemi një sistem unitar të drejtësisë?

Tahiri: Një nga të arriturat më të mëdha në vitin 2017 ka qenë inkuadrimi i pjesës veriore në sistemin e drejtësisë së Republikës së Kosovës. Sot qytetarët e Kosovës që nga Dragashi deri në Leposaviq ballafaqohen me një sistem të vetëm të drejtësisë, të bazuar në një kushtetutë të vetme, atë

evojë për EULEX-in



të Republikës së Kosovës. Mund të konfirmoj me përgjegjësi të plotë se puna është duke shkuar shumë mirë. Gjykatësit dhe prokurorët e komuniteteve joshumicë të inkuadruar në sistemin tonë të drejtësisë janë duke u trajnuar për ligjet e zbatueshme në Republikën e Kosovës, si dhe janë duke marrë në shqyrtim lëndët sipas legjislacionit në fuqi. Që nga tetori i vitit të kaluar e deri më tani nuk ka pasur asnjë indikacion që do të mund të vinte në pikëpyetje zbatimin efikas të marrëveshjes së Brukselit për drejtësi dhe se çdo gjë është duke shkuar mbi baza normale.

"Epoka e re": Te çështja e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe, Kosova ka nisur të hapet për hartimin e statutit

të këtij asociacioni, por kjo iniciativë është kundërshtuar nga Lista Serbe, e cila ka paralajmëruar për 20 prill themelimin e këtij asociacioni pa pëlqimin e palës së Kosovës. A do të ndodhë kjo njëanshëm dhe që ky asociacion të ketë kompetenca ekzekutive?

Tahiri: Lista Serbe është një subjekt politik që përfaqëson interesat e komunitetit serb që jeton në Kosovë dhe është pjesë e institucioneve tona edhe në Qeveri, edhe në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Megjithatë, çështja e themelimit të Asociacionit është një çështje për të cilën tashmë kornizat i ka vendosur Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës dhe se nuk mund të ketë klasifikime dhe kërkesa të jashtme që nuk janë në përputhje me atë që ka përcaktuar Gjykata

Kushtetuese. Megjithatë, besoj se themelimi i Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe është parë dhe duhet të shihet si një mundësi për bashkëpunim komunitar më efikas në mes të pjesëtarëve të komunitetit serb dhe se në këtë drejtim nuk ka asnjë shqetësim. Jam i bindur se edhe Lista Serbe në esencë e di se çfarë është në të vërtetë në interes të komunitetit serb, prandaj besoj se në kohën adekuate kur ekipet punuese të kenë hartuar statusin e Asociacionit, edhe Lista Serbe do të ketë reflektim pozitiv.

"Epoka e re": EULEX-i e përmbyll mandatin në qershor të këtij viti. A do të ketë nevojë Kosova më për këtë mision dhe a mund të ndodhë që t'i ripërtërihet mandati si herën e kaluar?

Tahiri: Sipas marrëveshjes ekzistuese, mandati i EULEX-it përfundon në qershor dhe ne si institucione jemi duke punuar për të marrë përsipër çdo aspekt që asnjë lloj zbrastënie të mos mbetet me rastin e përfundimit të këtij misioni. Në aspektin real, pa marrë parasysh performancën e EULEX-it në kuptimin e përgjithshëm, i njëjti ka kontribuar për fuqizimin e institucioneve vendore, veçmas organeve të pavarura të zbatimit të ligjit, prandaj në rrafshin praktik konsideroj se në kuptimin e ngushtë tashmë Republika e Kosovës nuk ka detyrimisht nevojë për këtë mision. Megjithatë, se a është e nevojshme një fazë tranzicioni të këtij mandati para se të thuhet i njëjti do të mbyllet përfundimisht dhe, nëse po, cili do të jetë roli i tij, kjo është një

çështje përcaktimi për të cilën i takon një nivel ndërinstitucional të vendimmarrjes. Si ministër i Drejtësisë jam i bindur se sistemi i drejtësisë, përkatësisht gjyqësori dhe prokuroria, tashmë kanë kapacitetet profesionale dhe buxhetore për ta bërë punën e tyre konform ligjeve në fuqi, pa pasur nevojë për një mision ekzekutiv të EULEX-it.

Si ministër do t'i kushtoj vëmendje të madhe mbrojtjes juridike të qytetarëve që janë subjekt i Speciales

"Epoka e re": Z. Tahiri, ju keni dhënë qëndrim sa i përket themelimit të Gjykatës Speciale dhe kundërshtimit që ka pasur kjo gjykatë, por deshëm të dimë se kur do të ngrihen aktakuzat, dhe cili është bashkëpunimi i Ministrisë së Drejtësisë me drejtuesit e kësaj gjykatë?

Tahiri: Gjykata Speciale paraqet një realitet juridik me ligjet në fuqi në Republikën e Kosovës dhe e njëjta është pjesë e sistemit tonë të drejtësisë me një mandat të definuar sipas ligjeve tona. Megjithatë, si çdo gjykatë tjetër që bën punën e vet konform ligjit e në mënyrë të pavarur, edhe kjo gjykatë vepron në pavarësi të plotë, prandaj nuk është në mandatin tim të di për përmbajtjen e aktakuzave, as numrin e të akuzuarve dhe as kohën se kur të njëjtat do të procedohen. Vitin e kaluar unë kam pasur një takim me kryetaren e kësaj gjykatë, zonjën Trendafilova, ku kam kërkuar siguri juridike, transparencë dhe përgjegjshmëri në punën e tyre dhe mund të them se Trendafilova ka shprehur përkushtimin e saj që në çdo rast eventual të ballafaqimit të qytetarëve tanë si subjekte para kësaj gjykatë, do të respektohen normat dhe parimet më të avancuara të të drejtave të njeriut që aplikohen në botën demokratike. Ajo çfarë unë i kam kushtuar vëmendje të madhe është mbrojtja juridike e qytetarëve tanë që eventualisht mund të jenë subjekt i paraqitjes para Dhomave të Specializuara. Jam duke themeluar një zyrë të veçantë brenda ministrisë që do të merret me aspektet procedurale të financimit të mbrojtjes juridike dhe do të angazhohem vazhdimisht që i tërë ky proces të përmbillet me siguri të plotë juridike për qytetarët tanë dhe që të dalë në shesh e vërteta për luftën e pastër të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Vijon në faqen 6

Kosova nuk ka më nevojë për EULEX-in



Vijon nga faqja 5

Numri i përmbauesve do të rritet

"Epoka e re": Këto ditë Ministria e Drejtësisë, në bashkëpunim me Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, respektivisht me Agjencinë për Investime dhe Përkrahje të Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA), ka hapur kampanjën 'Drejtësia dhe biznesi'. Përfaqësuesit e bizneseve janë ankuar për procedurat e zgjatura tek gjykatat. A keni ndërmarrë ndonjë veprim në këtë çështje?

Tahiri: Në kuadër të reformës së rishikimit funksional të sistemit të drejtësisë janë shtatë shtylla themelore që gjenerojnë debatin se si duhet të rregullohet sistemi i drejtësisë dhe në mesin e tyre, një shtyllë e veçantë i është kushtuar drejtësisë komerciale apo

drejtësisë që lidhet me të bërit biznes. Republika e Kosovës është shtet demokratik me një ekonomi të lirë të tregut ku sektori privat është dhe duhet të jetë gjeneruesi më i madh i punësimit dhe zhvillimit ekonomik. Për këtë jam angazhuar që sistemi i drejtësisë të ofrojë një infrastrukturë të mirëfilltë edhe për këtë sektor. Më parë ka ekzistuar një Gjykatë Ekonomike e cila është mbyllur, me gjasë, në mungesë të efikasitetit. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se ne si institucione të mos shqyrtojmë mundësitë për një gjykatë të re që trajton këto çështje apo për një riorganizim eventual nëpër degët e gjykatave themelore. Në kuadër të këtij procesi reformues, konsultimet janë duke vazhduar dhe epilogu i tyre do të na sjellë rekomandimet e arsyeshme se si të veprojmë më tutje, por e them me përgjegjësi të plotë se jam duke u angazhuar që kjo çështje të

marrë një orientim që do të jetë funksional dhe që i mundëson komunitetit të biznesit ballafaqim të denjë, efikas dhe të përgjegjshëm me sistemin e drejtësisë në Republikën e Kosovës.

"Epoka e re": Ka ankesa nga qytetarët se përmbauesit privatë po vonojnë zgjidhjen e rasteve. A keni ju ndonjë organ i cili mbikëqyrë punën e përmbauesve? Dhe, tash për tash, a është i mjaftueshëm numri i përmbauesve?

Tahiri: Profesionet e lira ligjore, ku bëjnë pjesë edhe përmbauesit, në përgjithësi janë një histori suksesi në Kosovë, të cilat kanë mundësuar efikasitet më të madh në qasjen në të drejta dhe kanë mundësuar një efikasitet më të madh në adresimin e çështjeve që lidhen me aspektin ekonomik. Megjithatë, si ministër i Drejtësisë e konsideroj tejet të nevojshme të rridefinohen edhe

një herë vlerat mbi të cilat këto profesione funksionojnë, veçmas në kuptim të adresimit të përgjegjësisë dhe llogaridhënies së tyre. Për të adresuar këtë çështje, këtë vit do të themelohet një njësi të veçantë brenda ministrisë e cila do të ketë mandat të plotë auditimi edhe nga aspekti i llogaridhënies edhe nga aspekti i përmbajtjes së punës së profesioneve të lira ligjore. Kjo mbikëqyrje e profesioneve ligjore, përkatësisht përmbauesve privatë, do të mundësojë transparencë, llogaridhënie dhe përgjegjësi të punës së tyre ndaj qytetarëve dhe subjekteve të tjera. Sa i përket numrit të përmbauesve, para disa javësh kanë bërë betimin edhe një numër i ri i tyre, por ky numër do të rritet edhe në të ardhmen mbi bazën e parimit të ofrimit të shërbimeve për të gjithë qytetarët, duke mbuluar kështu një shtrirje më të gjerë gjeografike.

Deri në fund të mandatit Shërbimi Korrektues do të jetë referencë e mirë për të gjitha vendet në rajon

"Epoka e re": Ministër, në burgjet e Kosovës ende nuk është arritur një standard për eliminimin e praktikave të paligjshme, p. sh., ka raste kur ikën i burgosuri, ka raste të vetëvrasjeve e të plagosjeve. Që nga ardhja juaj në krye të kësaj ministrie, a keni ndërmarrë masa për ngritjen e përgjegjësisë për parandalimin e dukurive negative?

Tahiri: Shërbimi Korrektues i Kosovës përgjithësisht është një sistem funksional që mbikëqyrë ekzekutimin e sanksioneve penale, për fuqizimin e të cilit jam i shqetësuar vazhdimisht. Është e natyrlig që një hapësirë ku sundojnë parimet e sigurisë në njërin anë dhe ato të të drejtave të njeriut në anën tjetër, jo gjithmonë është e lehtë për t'u menaxhuar. Në të kaluarën ka pasur edhe raste të devijimeve dhe praktikave të paligjshme për të cilat kam bërë një reflektim të thellë dhe besoj se gjendja në përgjithësi është në përmirësim e sipër. Kam vizituar çdo qendër korrektuese ku kam parë nga afër edhe gjendjen e të burgosurve dhe kapacitetet e stafit, edhe aspektet infrastrukturore ndaj të cilave e kam një plan pune. Tashmë jemi në proces të përgjithshëm të drejtorit të përgjithshëm të ShKK-së dhe besoj se vëmendja jonë për përmirësimin e përgjithshëm të aspektit të sigurisë, profesionalizmit të stafit dhe avancimit të mirëqenies së personave në vuajtje të dënimit, do të marrë orientim të matshëm, rezultat i së cilave do të jetë evitimi i parregullsive dhe praktikave të paligjshme në qendrat korrektuese. Jam i bindur se me angazhimin e mëtejshëm që jemi duke ndërmarrë, deri në fund të këtij mandati qeverisës, Shërbimi Korrektues i Kosovës do të jetë referencë e mirë për të gjitha vendet në rajon dhe më gjerë edhe në aspektin e sigurisë, edhe në atë të respektimit të të drejtave, dinjitetit dhe personalitetit të personave në vuajtje të dënimit.

Liderët institucionalë kanë bërë homazhe te varrezat e dëshmorëve në Koshare

Beteja e Koshares dëshmoi unitetin e luftëtarëve shqiptarë

Beteja e Koshares ka dëshmuar unitetin e luftëtarëve shqiptarë dhe fazën më të lartë të rezistencës së UÇK-së. Kështu është thënë në manifestimin tradicional "Ditët e shqipes", i cili organizohet për nder të betejës së Koshares. Në 19-vjetorin e kësaj beteje, ish-udhëheqësit e UÇK-së e kanë vlerësuar lart ndikimin e kësaj beteje në çlirimin e Kosovës

EPOKA
ERE

Faton DERMAKU

PRISHTINË, 9 PRILL - Kosova me krenari ka përkujtuar betejën e Koshares në 19-vjetorin e saj. Në kuadër të manifestimit tradicional "Ditët e shqipes", i cili organizohet për nder të betejës së Koshares, është vlerësuar lart kjo betejë dhe ndikimi që ajo ka pasur në çlirimin e Kosovës.

Presidentin Hashim Thaçi ka thënë se kjo betejë ka dëshmuar faktin se lufta e UÇK-së kishte hyrë në një fazë më të lartë të rezistencës. "Kujtojmë luftën e lavdishme të djemve dhe vajzave që iu bashkuan radhëve të Ushtrisë Çlirimtare fuqishëm pas shpalljes së mobilizimit të përgjithshëm nga Shtabi i UÇK-së. Në Koshare, UÇK-ja dëshmoi faktin se kishte hyrë në një fazë më të lartë të rezistencës. Me kapacitetet njerëzore dhe teknike ishte e aftë për t'u përballur me forcat serbe në luftë frontale. Si rezultat i përgatitjes taktike dhe strategjike, me aktet e vendosmërisë dhe trimërisë së pashembullt, u arrit një fitore historike, shembja e gurit të piramidës së

kufirit që kishte ndarë një shekull tokat shqiptare", ka thënë presidenti Thaçi, duke shtuar se Kosova me krenari kujton heronjtë Sali Çeku, Agim Ramadani, Xhemajl Fetahu dhe shpreh nderimet më të larta për invalidët dhe veteranët e betejës së Koshares dhe të Pashtrikut.

Presidenti Thaçi ka thënë se çdo fillimvit, veçanërisht në muajin mars, prill dhe maj, Kosova shënon ngjarje të dhimbshme dhe krenare, të sakrificës dhe të rezistencës, të lidhura me vitet e luftës 1998-1999. "Edhe në këtë 19-vjetor të çlirimit dhe 10-vjetor të Pavarësisë së Kosovës u kujtuam masakra e Likoshanit dhe e Çirezit, Epopeja e UÇK-së në Prekaz, Epopeja e Dukagjinit, masakra në Krushë, në Celinë, në Izbicë e në Rezallë. Do të shënohen e kujtohen me respekt e dhembje ngjarje të ngjashme në muajt në vijim, për të na rikujtuar faktin që liria dhe pavarësia e Kosovës kanë pasur një çmim të lartë", ka thënë ai.

Sikurse edhe presidenti, homazhe te varrezat e dëshmoreve të kësaj beteje ka bërë edhe kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, nën



përkujdesjen e të cilit është mbajtur ky manifestim. Me këtë rast, ai ka thënë se shembja e kufirit ndërshqiptar në Koshare i ka ndërruar rrjedhën historisë dhe është dëshmi se shqiptarët asnjëherë nuk e pranojnë robërinë. "Të jesh këtu në 19-vjetorin e betejës heroike të Koshares, të përulesh para të gjithë këtyre dëshmorëve e heronjve të lirisë nga Brigada 138, që në kujtesën shtetërore paraqet thyerjen e kufirit ndërshqiptar, e që do të thotë, po ashtu, unitetin e luftëtarëve shqiptarë, të njohur tanimë, heronjve tanë Agimit, Salihut, Xhemajlit e gjithë të tjerëve. Të bëhesh pjesë në 'Ditët e shqipes' është jo vetëm nder, por edhe betim se do t'i dalim zot atdheut", ka thënë Haradinaj.

Betejën e Koshares e ka kujtuar edhe kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli. Në profilin e tij në "Facebook", ai ka shkruar se "Brigada 138 Agim Ramadani" kishte përpara një detyrë të veçantë historike, që ishte shembja e murit që padrejtësisht ndau kombin shqiptar. "19 vjet më parë nga Kosharja e deri në malet e Shalës, nga Maja e Pashtrikut e deri në Bjeshkët e Kaçanikut, UÇK-ja luftonte me vendosmëri përballë makinerisë gjenocidale të Serbisë. Në ato ditë të lavdishme 'Brigada

138 Agim Ramadani' kishte përpara një detyrë të veçantë historike: shembjen e kufirit të dhunshëm, që për gati një shekull e ndau në dysh kombin tonë. Për dy muaj rresht, betejë pas beteje, nga të gjitha trevat shqiptare, ranë qindra luftëtarë të lirisë. Qindra të tjerë morën plagë e shumë humbën gjymtyrët e trupit. Por, ëndrrën e Kosovës e bënë realitet. Lavdi dëshmorëve të Koshares dhe gjithë dëshmorëve të lirisë", ka shkruar Veseli në profilin e vet në "Facebook".

Betejën e Koshares, si një ndër betejat më të lavdishme të UÇK-së, e ka vlerësuar edhe kryetari i Nismës Socialdemokrate, njëherësh zëvendëskryeministër në Qeverinë e Kosovës, Fatmir Limaj. "19 vjet më parë në Koshare u zhvillua një nga betejat më të lavdishme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Beteja e Koshares i dha një impuls të ri luftës së drejtë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës duke mundësuar kështu furnizim më të lehtë me armatim. Kosova sot e kujton me nder e krenari këtë betejë, e cila i dha goditjen përfundimtare forcave okupuese serbe në Kosovë. Sot ne të gjallët me respekt kujtojmë burrat, gratë dhe të gjithë ata që sot nuk janë në mesin tonë. Lavdi e përlujë për të

gjithë ata që ranë për lirinë e Kosovës", ka shkruar ai në profilin e tij në "Facebook".

Ndërsa sipas liderit të LDK-së, Isa Mustafa, beteja e Koshares shënon fitoren më të madhe të UÇK-së mbi forcat e armikut. "Beteja triumfale e Koshares, e zhvilluar 19 vjet më parë, shënon fitoren më të madhe në betejë të hapur të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës mbi forcat e armikut. Uniteti dhe profesionalizmi i ushtarakëve tanë e bënë të pashmangshme disfatën e ushtrisë dhe të paramilitarëve të Serbisë", ka shkruar Mustafa në llogarinë e vet në "Facebook".

Këtë betejë e ka kujtuar edhe lideri i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti. "Forcat e UÇK-së sulmuan në kundërpërgjigje të terrorit dhe spastrimeve mizore që kishte nisur t'i bënte Serbia në Kosovë. Çlirimtarët tanë heroikë u mbështetën edhe nga Ushtria e Shqipërisë, edhe nga forcat e NATO-s. I përulemi me respekt të thellë kujtimin të lavdishëm të dëshmorëve e heronjve të kombit që ranë në Koshare, por edhe veteranëve të kësaj beteje. UÇK-ja është themeli i lirisë sonë. Çdo hap shtetndërtues që e hedhim pa e kujtuar luftën çlirimtare, është hap i pasigurt", ka shkruar Kurti në profilin e vet në "Facebook".



Kosova pritet ta krijojë sot Komisionin Hetimor për shtetasit turq

PRISHTINË, 9 PRILL - Shefat e grupeve parlamentare pritët të mblidhen sot (e martë) për ta nisur punën rreth krijimit të komisionit hetimor për t'i ndriçuar rrethanat e dëbimit të gjashtë shtetasve turq më 29 mars.

Organizata të ndryshme ndërkombëtare si dhe kritikë

vendorë kanë thënë se dëbimi i tyre paraqet shkelje të të drejtave të njeriut si dhe shkelje të Kushtetutës së Kosovës. "Shefat e grupeve parlamentare do të takohen ditën e martë dhe unë pres që po të njëjtën ditë ta konstitujmë komisionin hetimor", ka thënë për "REL" shefi i grupit

parlamentar i Nismës Socialdemokrate, Bilall Sherifi.

Edhe deputetja e Lëvizjes Vetëvendosje, Arbërie Nagavci, beson se ky komision do ta fillojë punën këtë javë. Sipas saj, komisioni duhet të gjejë se kush ishin urdhëruesit e dëbimit të shtetasve turq.



Prodhimtaria vendore, nën hijen

Tejkalimi i projeksionit të të hyrave nga Dogana e Kosovës për periudhën janar-mars të këtij viti është shqetësues për kryetarin e Odës Ekonomike të Kosovës, Safet Gërxhaliu dhe ish-ministrin e MTI-së, Ismet Mulaj, pasi kjo ka ndikuar në eksportim të parasë së gatshme dhe rritje të importit duke e vënë kështu nën hije prodhimtarinë vendore. Ndërsa Burim Piraj, pronar i fabrikës së përpunimit të mishit "Meka", ka thënë se Kosova prodhon shumë pak lëndë të parë

EPOKA E RE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 9 PRILL - Dogana e Kosovës gjatë periudhës janar-mars të këtij viti ka shënuar rritje të të hyrave për 2 për qind apo 4.1 milionë euro më shumë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2017. Po ashtu, edhe Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) gjatë tremujorit të parë të këtij viti ka shënuar rritje për 13.3 për qind apo 12.7 milionë euro më shumë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2017. Ndonëse për buxhetin e shtetit tejkalimi i projeksioneve buxhetore sa iu përket të hyrave nga ana e Administratës Tatimore të Kosovës dhe Doganës së Kosovës për tre muajt e parë të këtij viti në shikim të parë duket lajm pozitiv për komunitetin e biznesit në Kosovë, ky lajm nuk është mirëpritur, për faktin se tregon rritje të importeve dhe pamundësisë së prodhimtarisë vendore.

Kreu i Odës Ekonomike të

Kosovës (OEK), Safet Gërxhaliu, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se është shqetësues rritja e të hyrave në Doganën e Kosovës për arsye se kemi të bëjmë me eksportim të parasë së gatshme. Ai ka apeluar që Kosova ta ketë një qeverisje pro ekonomike në mënyrë që të gjejë alternativa për balancim të importit dhe eksportit. "Është shqetësuese që edhe më tutje indikatorë të grumbullimit të të hyrave për Qeverinë e Kosovës janë Dogana dhe ATK-ja. Pra, është shqetësues fakti se kemi rritje të të hyrave në Doganë që nënkupton orientimet bazike në tregti. Kështu që, Kosova edhe më tutje është duke vazhduar avazin e eksportit të parasë së gatshme. Tani është koha kur duhet të gjenden format alternative që ky bilanc të jetë në favor të zhvillimit ekonomik, krijimit të vendeve të reja të punës dhe në favor të përmirësimit të imazhit", ka thënë Gërxhaliu, duke shtuar se nëse vazhdohet kështu, shoqëria e Kosovës edhe më tutje do të



jetë e varur nga importi. "Një shoqëri që është e varur nga tregtia dhe importi, ardhmërinë e vet e ka të dobët", ka thënë ai. Gërxhaliu ka theksuar se tani është koha për një orientim pro zhvillimit ekonomik. "Duhet të jemi të orientuar kah sektori pri-

vat dhe ai prodhues. Këta sektorë duhet ta kenë vëmendjen e merituar", ka deklaruar Gërxhaliu. Ai ka theksuar se vetëm në kampanja të fushatave zgjedhore ka premtime, pastaj ato as nuk realizohen.

Gërxhaliu ka pohuar se nuk

mjafton në këtë drejtim vetëm mbështetja nga Ministria e Financave. Sipas tij, sot për çështje ekonomike kemi gjashtë dikasterë në kuadër të institucioneve të vendit. "Duhet të ndodhë një koordinim më i mirë i aktiviteteve, qoftë promovuese apo mbështetëse. Mbi të gjitha, duhet një diplomaci ekonomike aktive e cila do të krijojë mundësi të hapjes së produkteve 'Made in Kosova'. Nga këndvështrimi ynë si Odë Ekonomike është shqetësuese jo vetëm situata aktuale në Kosovë, por edhe avancimi dhe rritja e eksporteve në vendet e rajonit", ka thënë kreu i OEK-ut, Safet Gërxhaliu.

Edhe ish-ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Ismet Mulaj, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se tejkalimi i të hyrave sa i përket Doganës së Kosovës nënkupton import më të lartë. "Tejkalimi i planit nga ana e Doganës nënkupton që Kosova në tre muajt e shkuar ka pasur shumë më shumë import sesa eksport. Kjo do të thotë se janë nxjerrë shumë më shumë para jashtë Kosovës sesa vitin e kaluar", është shprehur Mulaj.

Ndërsa sa i përket ATK-së, ai ka theksuar se ka pasur një iniciativë të zvogëlimit të informalitetit. "Ka pasur mundësi për të pasur të ardhura më shumë. Edhe sipas ASK-së, eksportet kanë rënë dhe prodhimi është më i vogël. Gjithashtu, kemi edhe çmim të energjisë më të lartë", ka thënë Mulaj. Ai ka shtuar se efektet e pakos fiskale



e importit



nuk mund të vërehen menjëherë. "Duhet kohë për t'u vërtetuar efektet e pakos fiskale. Aftësia prodhuese në Kosovë është e vogël dhe nuk mund të kemi efekte të menjëhershme të pakos fiskale", është shprehur Mulaj, duke shtuar se reformat

fiskale nuk janë të vetmet që krijojnë ambient prodhues në Kosovë. "Janë dhe një sërë faktorësh të tjerë që ndikojnë në ambientin prodhues, si: energjia, sundimi i rendit dhe ligjit si dhe mundësitë për aftësi konkurruese", ka thënë Mulaj.

Piraj: Kosova prodhon shumë pak lëndë të parë

Pronari i fabrikës së përpunimit të mishit "Meka", Burim Piraj, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se rritja e importit nuk do të thotë se ka rënie të prodhimit të brendshëm. "Ka shumë pak lëndë të parë që prodhohet kryekëput në Kosovë. Prodhimi primar në Kosovë ka pësuar më së shumti dhe është një nga degët industriale me të cilën duhet të merren më së shumti institucionet vendore. Në fakt, ka pasur shumë grante për prodhimin primar në bujqësi, sidomos për ta fuqizuar prodhimin vendor të lëndës së parë, mirëpo unë mendoj se mënyra e dhënies së granteve ka qenë e gabuar dhe nuk i ka dhënë rezultatet e pritura. Thënë më shkurt, nuk duhet subvencionuar toka që ka në pronësi bujku, por duhet të subvencionohet sasia e produktit për kilogram ashtu siç aplikohet

në pothuajse të gjitha vendet e rajonit. Duke u nisur nga ky aspekt, importi më i madh mund të nënkuptojë edhe rritje të përpunimit në vendin tonë", është shprehur Piraj. Sipas tij, nëse të dhënat nga Dogana dhe ATK-ja tregojnë se e kanë tejkaluar projeksionin e të hyrave, është një tregues shumë i mirë makroekonomik i cili na jep shpresë për ditë më të mira. "Këtë vit Dogana ka liru një pjesë të lëndës së parë nga taksa doganore, mirëpo ka edhe lirim nga taksa të pothuajse të gjitha produkteve që importohen nga Unioni Evropian për në Kosovë, gjë që ka ndikim të drejtpërdrejtë në të hyrat buxhetore. Nëse edhe përkundër kësaj kemi rritje, atëherë mendoj se kjo do të ketë ndikim shumë pozitiv në veprimtarinë prodhuese në vend", ka deklaruar Piraj.

Vend i varfër, por me shumë ditë pushimi

PRISHTINË, 9 PRILL - Nëse një festë zyrtare në Kosovë i bie ditën e shtunë ose të diel, pushimi bartet të hënën. Të gjitha institucionet e Kosovës kanë pushuar ditën e hënë, kur vendi shënon Ditën e Kushtetutës si dhe për nder të Pashkëve Ortodokse, të cilat kanë qenë të dielën. Kosova në muajin e ardhshëm feston edhe Ditën e Evropës, ditë kjo që është ditë pune për qytetarët e vendeve të Bashkimit Evropian.

Ligji për festat zyrtare ka gjithsej 11 festa dhe respektohet në tërësi nga institucionet publike, derisa shumë nga bizneset e sektorit privat e kanë ditë pune.

Përfaqësues të sindikatës së punëtorëve dhe të komunitetit të biznesit e konsiderojnë urgjente nevojën e trajtimit të Ligjit për festat zyrtare dhe largimin e traditës që festat që bien në fundjavë, të barten për ditën pasuese të punës.

Duke qenë një nga vendet më të varfër në Evropë, kjo traditë pengon produktivitetin e përgjithshëm të vendit, kurse krijon një barrë më tepër financiare tek sektori privat.

Kryetari i Bashkimit të Sindikatës së Pavarur të Kosovës (BSPK), Avni Ajdini, ka thënë se kalendari i festave

zyrtare është shumë i ngarkuar si dhe dallon sektori privat me atë shtetëror. "Në sektorin privat punëtorët gjithmonë janë humbës. Pasi deri më tani nuk zbatohet as Ligji i Punës dhe Kontrata Kolektive, e cila është e nënshkruar nga Qeveria e Kosovës", ka thënë Ajdini.

Në anën tjetër, Oda Ekonomike Amerikane në Prishtinë ka vite që ka kërkuar reduktimin e numrit të festave dhe mos të ketë lidhje të fesave nga fundjava në ditët e punës. Drejtori ekzekutiv i Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë (OEAK), Arian Zeka, ka bërë me dije për "Radion Evropa e Lirë" se numri i madh i festave zyrtare paraqet një problematikë për bizneset në Kosovë, pasi ua pamundëson bizneseve të jenë produktive dhe rritë koston e prodhimit. "Që nga viti 2013 kemi kërkuar ndryshimin e Ligjit për festat zyrtare, të hiqen disa nga festat zyrtare, siç është 9 Maji - Dita e Evropës - që është një paradoks më vete, pasi për këtë datë ditë pushimi nuk kanë as vendet e anëtare të Bashkimit Evropian e jo më në Kosovë, i cili shtet nuk e ka as statusin e kandidatit në BE. Mendoj se ka hapësirë për përmirësime, sidomos te festat fetare. Kosova është shtet i veçantë në këtë aspekt", ka theksuar Zeka.

Edhe disa qytetarë shprehen se duhet të ketë reduktim të ditëve të pushimit gjatë festave. Albina Berisha, e cila është pronare e një dyqani në qendër të Prishtinës, thotë se nuk pushon në të gjitha festat që shënohen në Kosovë. "Unë punoj edhe sot. Mendoj se numri i festave zyrtare është shumë i madh. Numri i madh i këtyre festave dhe lidhja e tyre me ditët e punës na pengon në procesin e punës. Madje edhe punëtorët kërkojnë pushim ose pagesë më tepër për këto ditë", ka thënë Berisha.

Festat zyrtare në Kosovë të përcaktuara me ligj janë: Viti i Ri, Dita e Pavarësisë së Republikës së Kosovës, Dita e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Dita Ndërkombëtare e Punës, Dita e Evropës, Bajrami i Madh, Bajrami i Vogël, Krishtlindjet Katolike, Krishtlindjet Ortodokse, Pashkët Katolike, si dhe Pashkët Ortodokse. Përveç këtyre festave, në Kosovë, sipas ligjit, janë të përcaktuara edhe tetë ditë të tjera memoriale. Data 28 nëntor shënohet si Dita e Flamurit të shqiptarëve dhe 12 Qershori - Dita e Paqes, e që për të dy ditët pushohet. Kurse gjashtë festat e tjera memoriale i përkasin ditës së komuniteteve të ndryshme që jetojnë në Kosovë.



Nis rregullimi i kanalizimit në Dragaqinë të Suharekës

SUHAREKË, 9 PRILL - Në Komunën e Suharekës janë duke vazhduar projektet të cilat kanë për synim mirëqenien e qytetarëve.

Kryetari i Komunës së Suharekës, Bali Muharremaj, ka bërë me dije se tani ka filluar rregullimi i kanalizimit në Dragaqinë. "Ky projekt do të

vazhdojë së implementuari me intensitet të shtuar të punimeve. Në secilën hapësirë të komunës sonë do të jemi vigjilentë për mbikëqyrjen e

punimeve", ka thënë Muharremaj. Po ashtu, ai ka bërë me dije se në qytetin e Suharekës është duke vazhduar edhe pastrimi i rrugëve.



Sami Lushtaku: PDK-ja po hyn e unifikuar në zgjedhjet e brendshme

Lushtaku ka kërkuar angazhim nga të gjithë për organizimin e zgjedhjeve në 57 nëndegë të RDK-së. Ai ka kërkuar që uniteti i plotë i Degës së PDK-së të vazhdojë edhe në zgjedhjet e brendshme.

SKENDERAJ, 9 PRILL - Kryetari i Degës së Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) në Skenderaj, Sami Lushtaku, ka takuar të hënën kryetarët e degëve dhe të seksioneve të partisë dhe strukturat e Rinisë Demokratike të Kosovës (RDK) me qëllim të mobilizimit për zgjedhje e brendshme në parti. Lushtaku ka kërkuar angazhim nga të gjithë për organizimin e zgjedhjeve në 57 nëndegë të RDK-së. Ai ka kërkuar që uniteti i plotë i Degës së PDK-së të vazhdojë edhe në zgjedhjet e brendshme. "Kërkoj angazhim nga strukturat e partisë që të punojnë në terren për ta ndihmuar procesin zgjedhor duke u dhënë mundësi të gjithë të rinjve nga 16 deri në 25 vjeç që të jenë pjesë e procesit zgjedhor

në RDK", ka thënë Sami Lushtaku.

Ai ka siguruar se PDK-ja në Skenderaj do të jetë e hapur për të gjithë duke krijuar mundësi të barabarta për secilin. "Dega e PDK-së në Skenderaj është unike dhe e përgatitur për mbajtjen e zgjedhjeve të brendshme me qëllim të hapjes ndaj të rinjve, duke u krijuar mundësi të barabarta për secilin qytetar të Skenderajt, për ta përfunduar programin politik të partisë dhe për të qenë pjesë e reformimit të brendshëm", ka theksuar kryetari Lushtaku.

Në takim komisioni për organizimin e zgjedhjeve ka prezantuar orarin e kuvendeve të nëndegëve të RDK-së që do të fillojnë të mbahen nga dita e mërkurë.



Fatura e mbeturinave, kusht për regjistrim të veturave



PRISHTINË, 9 PRILL - Zyrtarët e Komunës së Prishtinës kanë bërë me dije se vetëm 10 483 persona i janë përgjigjur pozitivisht kërkesës së komunës nga mbi 50 mijë sa janë të regjistruar për ta paguar faturën e mbeturinave. Kjo shifër është e ulët për kryeshefin e kompanisë "Pastrimi", Feim Salihu. "Fakti që fatura është si kështu dhe brenda në këtë faturë janë tre muaj do të bëjë që më pak qytetarë të paguajnë. Sikurse faturat të dërgoheshin për çdo muaj, inkasimi do të ishte më i lartë", ka thënë Salihu për "038 i KTV-së". Ai ka shtuar se derisa ata grumbullonin paratë, mbi 40 mijë qytetarë paguanin faturat për çdo muaj. "Në këtë ka ndikuar edhe fakti që ne kemi pasur

gjashtë pika në të cilat qytetarët mund të paguajnë dhe, për më tepër, kemi shkuar për ta kërkuar borxhin edhe nëpër shtëpi", ka thënë Salihu. Megjithatë, sipas tij, deri më tash Komuna e Prishtinës u ka paguar atyre dy këste, sipas kontratës që kanë lidhur bashkë. Për ta rritur numrin e paguesve të faturave, komuna pritet që nga kësti i tretë, që nis më 1 korrik, t'i detyrojë qytetarët të paguajnë duke i kushtëzuar me regjistrim të automjeteve. Jozyrtarisht punëtorët nëpër sportele kanë thënë se po përgatiten që këtë metodë ta nisin më shpejt, por që në rregulloren për mbeturina thuhet se kushtëzimi bëhet pas mospagesës së kështit të tretë.

Prishtina sot fillon grumbullimin e mbeturinave të vëllimshme

PRISHTINË, 9 PRILL - Komuna e Prishtinës ka njoftuar se nga sot (e martë) fillon aksionin për grumbullimin e mbeturinave të

vëllimshme. Sipas zyrtarëve komunalë, grumbullimi i mbeturinave të vëllimshme do të fillojë në lagjet "Medrese", "Gjinaj",

"Taslixhe", "Bledi", "Vreshta" dhe "Çamëri". Qytetarët obligohen që në lagjet e caktuara, sipas datave, t'i vendosin mbeturinat

para shtëpive të tyre, apo në periudhën kohore nga 9 deri më 13 prill t'i sjellin vetë ato në kompaninë "Pastrimi".



Mosbindja qytetare



Nga Blerta HAXHIAJ

Lëvizja e parë politike mund të quhet despotike nëse ajo është e lidhur me diskursin historik të botës politike, përmban një thesar përmbartues. Eurocentrizmi mund ta përshpejtojë papërshatshmërinë e despotizmit. Pikëpamja teorike është norma e një disipline akademike nëse duhet shpjeguar mosbindja qytetare. 'Njerëzit rebelë' apo ajo që Michel Foucault referohet si riaktivizim apo rijetimit të temave antike në diskutet e despotizmit, asnjëherë nuk e elaboron faktin se zbulimet që shfaqen ndaj bindjeve dhe mosbindjeve qytetare janë të paraqitura si figura despotike. Asnjë problem apo dhimbje nuk mund të haset nga leximi i pafajshëm, sepse despotizmi është një karikaturë dhe mund të

grykohet nga efektet e saj që njerëzit dhe instancat e larta duhet ta kuptojnë dhe realizojnë rrezikun e përballjes. Efikasiteti i afrimit dialektik në teorinë sociale kritike zënë vend produktiv në mendimin e sotëm politik, por edhe në praktikën e saj. Mosbindja civile është e drejtë morale, etike dhe e shtetasve të shtetit të së drejtës. Produktiviteti i mbipërcaktimit qëndron në nocionin se forma specifike e një formimi social po zhvillohet vazhdimisht (në përgjigje të strukturës dominuese), gjë që kërkon një kthim të pafund në momentin specifik të konjunkturës në mënyrë që ta artikulojë formën e saj. Ideologjia prodhon subjekte, si dhe kategorinë subjektive - e cila është konceptuar si një person i pajisur me aftësinë për t'i identifikuar idetë dhe praktikatat që ai beson dhe merr pjesë përpara se të veprojë kështu. Si një mekanizëm adaptive, individit e sheh veten të reflektuar në institucionet dhe praktikatat e një shoqërie, për të cilën ka nevojë dhe janë të përshtatur. Shteti dhe aparati shtetëror kanë kuptim nga pikëpamja e luftës së

klasave por në ditët e sotme ky term tashmë është shndërruar në 'shtresa', dallimin që në shtresa që paraqitet si opresion dhe kushte të garantuara për një eksploatim/riproduktim. Mirëpo nuk ka luftë mes klasave pa klasa antagonistë. Mes funksionimit ideologjik që prodhon një nocion partikular të subjektivitetit individual ofron funksionimin diferencial ideologjik që prodhon kontradikta mes subjekteve politike dhe subjekteve votuese. Hapësira e ofruar me tendencë të mosbindjes qytetare bazohet mbi ideologjinë e cila në kundërshtim dhe fundamentalisht duhet të jetë relacionale për subjektet në fjalë. Riprodhimi i çdo organizimi social mund të jetë një shoqëri eksploative ose parti revolucionare. Singulariteti dhe përsëritja e përbashkët kanë lokalizimin e organizatës sociale më të gjitha elementet e saj. Si pjesë e demokracisë mosbindja qytetare është e mirëpritur për një mirëmbajtje sa më të mirë sociale për gjeneratat në vazhdim. Mirëpo mosbindja civile domosdoshmërit nuk mund të drejtojë ndaj një

revoltë apo protestë, gjithmonë mosbindja qytetare merret me konotacione paqësore. Me 17 prill 2018 marrim një lajm të mirë për Shqipërinë, që është rekomandimi i Komisionit Evropian për hapjen e negociatave me Shqipërinë. Ndërkohë që problemet e reformave janë në proces e sipër më finalizimet e tyre. Por a do ta ndjekë kush opozitën? Është e vërtetë se ndihma ekonomike është një harxhim shumë më i përballueshëm për shtetin se sa të ardhurat që mund të fitojë individit. Çështja nuk është se a do ta ndjekë kush opozitën sepse respektivisht si sistem parlamentar duhet të ekzistojë opozita, a kanë vullnet Shqiptarët të ndryshojnë ligjet dhe mënyrën e jetesës! Mosbindja qytetare ka mënyra të ndryshme për t'u shfaqur, nuk mund të eliminohej dhuna apo edhe mosdhuna. Nuk mund të anashkalohet motivi ekonomik që zmadhon mosbindjen qytetare të rolit strukturor që e determinon atë. Montesquieu - "aty ku ekzistojnë ligjet, liria nuk mund të nënkuptojë veprimet e gjithë asaj që dëshirohet. Liria

është e drejtë që të bëhet e gjithë ajo që ligjet lejojnë, nëse një qytetar mund të bëjë atë që ligjet ndalojnë, nuk do të ketë liri për askënd". Nëse ekonomia është vetëm dominante në rastin e fundit, kjo do të thotë se është e mundur që një strukturë tjetër të jetë dominante në çdo rast tjetër, megjithëse për arsye ekonomike. Njeriu është një 'kafshë' politike (Aristotle) duke kontribuar për vendin që jeton. Në politike çdo gjë rrjedh dhe kalon në hallkat e zinxhirëve të pushtetit, mosbindja civile/qytetare është një kundërshti e pastër nëse arrihet të mbahet në pastërtinë e saj të kulluar. Elementi i propagandës ndikon drejtpërdrejtë në mosbindjen qytetare, pjesa e kulluar nuk është e pastër domosdoshmërisht sepse është e kaluar në sitën e pushtet/politikës. Lëvizja e fundit në politikë është demokratike në qoftë se ajo është e lidhur me diskursin politik, paraqitet më despotike se vet despotizmi.

(Autorja është zëvendëskryetare e Shoqatës së Sociologëve të Kosovës)

Komuniteti i marginalizuar rom ende më i përjashtuari në Ballkanin Perëndimor

Statistikat e para në shtatë vjet tregojnë rritje të vijimit të mësimin në Ballkanin Perëndimor, por ka dallim në rritje midis romëve dhe joromëve në shëndetësi, punësim dhe strehim

BRUKSEL, 9 PRILL - Më shumë vajza dhe djem të marginalizuar romë po ndjekin arsimin e detyrueshëm në Ballkanin Perëndimor sesa kurrë më parë. Megjithatë, në krahasim me fqinjët e tyre joromë, romët përballen me papunësi dy herë më të lartë dhe kanë më pak të ngjarë ta vizitojnë mjekun kur është e nevojshme ose të bien në gjumë të ngopur. Këto të dhëna dalin nga një sondazh i ri i mbështetur nga Komisioni Evropian dhe i implementuar nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) dhe Banka Botërore.

Anketa rajonale për romë mbledh për herë të parë, që nga viti 2011, të dhëna për romët e marginalizuar në Kosovë, Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë, ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, Mal të Zi dhe Serbi.



Anketa tregon se nivelet e përfundimit të shkollës në mesin e romëve ende mbeten prapa pjesës tjetër të popullsisë, ku vajzat rome janë në fund të listës.

Shkalla e lartë e papunësisë e kombinuar me një numër të madh të rinjve që nuk janë regjistruar në shkollë kon-

tribuojnë në disavantazhin e romëve të rinj të marginalizuar. Studimi tregon fusha të tjera ku janë bërë përmirësime të rëndësishme që nga viti 2011 ose janë ende të nevojshme. Për shembull, në shumicën e vendeve romët tani kanë më shumë gjasa të kenë qasje në grumbullimin e mbeturinave. Ata kanë më pak

gjasa të jetojnë në familje të mbipopulluara, edhe pse ende ka dallime të mëdha në raport me fqinjët e tyre joromë. Por, një pjesë e madhe e popullsisë rome ende jeton në zonat pa ujësjellës.

Nga ana tjetër, numri i romëve që tani kanë dokumente personale, si certifikata të lindjes

dhe letërnjoftime, është rritur në shumicën e vendeve. Një numër më i vogël i romëve raportojnë që nevoja për kujdes mjekësor nuk përmbushet.

Për shkak se romët përballen me një sërë disavantazhe të tilla, kërkohet qasje e re për t'i adresuar të gjitha aspektet në të njëjtën kohë.

Papa dënon sulmin e dyshuar kimik në Siri

VATIKAN, 9 PRILL - Papa Françesku e dënoi fuqishëm sulmin e dyshuar kimik në Douma të Sirisë, duke e cilësuar si përdorim të pajustificueshëm të "instrumenteve të shfaros-

jes". "Lajme të tmerrshme të bombardimeve vijnë nga Siria me dhjetëra viktima, nga të cilat shumë janë gra dhe fëmijë. Lutemi për të vdekurit, për të

plagosurit dhe për familjet që vuajnë", tha Papa. Ai u bëri thirrje udhëheqësve politikë dhe ushtarakë ta zgjedhin rrugën e negociatave si mënyrë e vetme për arritjen e paqes.

Sipas aktivistëve dhe burimeve spitalore, së paku 40 veta janë vrarë në sulmin e dyshuar me gaz klori, që ka ndodhur të shtunën në qytetin e kontrolluar nga rebelët sirianë.



Mattis: Nuk përjashtojmë veprimin ushtarak kundër Sirisë

Sekretari amerikan i Mbrojtjes, Jim Mattis, thotë se gjëja e parë që duhet ta shqyrtojmë është se përse ende përdoren armë kimike kur Rusia ishte garantuesja për heqjen e të gjitha armëve kimike

UASHINGTON, 9 PRILL - Sekretari amerikan i Mbrojtjes, Jim Mattis, thotë se Shtetet e Bashkuara nuk përjashtojnë një veprim ushtarak kundër Sirisë pas komenteve të presidentit Donald Trump, se ata që ndërmorën sulmin kimik të së shtunës do të paguanin një çmim të lartë. "Gjëja e parë që duhet të shqyrtojmë është se përse ende përdoren armë kimike kur Rusia ishte garantuesja për heqjen e të gjitha armëve kimike", tha Mattis gjatë një takimi në Pentagon me sheikun e Katarit al-Thani. Ai u tha gazetarëve se ShBA-ja po "punon me aleatët dhe partnerët nga NATO-ja në Katar dhe gjatë për ta trajtuar këtë çështje".

Të dielën në mbrëmje Shtëpia e Bardhë tha se presidenti Trump dhe presidenti francez Emmanuel Macron dënuan ashpër sulmet kimike në Siri dhe u morën vesh që Qeveria siriane e presidentit Bashar al-Assad duhet "të mbahet përgjegjëse



për abuzimet e vazhdueshme me të drejtat e njeriut". "Ata u morën vesh të shkëmbejnë informacion mbi natyrën e sulmeve dhe të koordinojnë një përgjigje të fortë dhe të përbashkët", tha Shtëpia e Bardhë në një

deklaratë rreth telefonatës midis dy udhëheqësve. Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara është takuar të hënën rreth sulmit të supozuar, pasi shumë vende kërkojnë një seancë urgjente.

Siria dhe Rusia akuzojnë Izraelin për sulm ajror

Siria dhe Rusia thonë se dy aeroplanë luftarakë izraelitë që vepronin në hapësirën ajrore libaneze kryen të hënën në mëngjes një sulm kundër një baze ajrore në Sirinë qendrore. Ushtria izraelite nuk e komentoi sulmin në bazën e njohur si T4 në provincën Homs.

Vëzhguesi sirian për të Drejtat e Njeriut me seli në Londër tha se 14 veta janë vrarë, në mesin e tyre edhe pjesëtarë të forcave iraniane. Në muajin shkurt Izraeli akuzoi forcat iraniane se po shfrytëzojnë bazën për të dërguar avionë pa pilotë në territorin e Izraelit.

Fillimisht mediet shtetërore siriane thanë se një sulm me raketa ka ndodhur të hënën në një bazë ajrore në provincën e Homsit në Siri, duke lënë një numër viktimitash.

Zyrtarët amerikanë thanë se ShBA-ja nuk ka kryer sulm në Siri. "Megjithatë, po vazhdojmë ta ndjekim nga afër situatën dhe t'i mbështesim përpjekjet diplomatike për t'i mbajtur përgjegjës ata në Siri dhe gjetiu për përdorimin e armëve kimike", tha në një deklaratë zëdhënësi i Pentagonit, Christopher Sherwood.

Siria vazhdimisht ka mohuar përdorimin e armëve kimike gjatë konfliktit që filloi në vitin 2011, përfshirë



edhe sulmin e fundit të dyshuar të së shtunës në para lagjet e Damaskut të kontrolluara nga kryengritësit, që la pas vetes 40 të vrarë.

Presidenti Trump përdori rrjetin "Twitter" të dielën për të thënë se "do të ketë një çmim të lartë për t'u paguar", për atë që ai e quajti "sulm të çmendur kimik" të shtunën.

Në një akt të rrallë kritikash të forta në adresë të udhëheqësit rus, presidenti amerikan deklaroi se presidenti Putin, Rusia dhe Irani janë përgjegjës për mbështetjen që i japin "kafshës Asad". Ai kërkoi nga Siria hapjen e zonës për personelin mjekësor dhe verifikues.

Ministria e Jashtme ruse hodhi poshtë pohimet për sulm kimik duke theksuar se "përhapja e tregimeve të rreme për përdorimin e klorit dhe substancave të tjera helmuese nga forcat qeveritare siriane vazhdon". "Ne kemi paralajmëruar disa herë së fundmi për provokime të tilla të rrezikshme. Qëllimi i një spekulimi të tillë mashtrues, pa asnjë argument, është mbrojtja e terroristëve dhe përpjekja për ta justifikuar përdorimin e forcës nga jashtë", thuhet në deklaratën e Moskës.

Irani tha se pretendimet e ShBA-së synojnë arsyetimin e veprimeve të reja ushtarake amerikane.

LAJME SHKURT

Orban, fitues i zgjedhjeve në Hungari

BUDAPEST, 9 PRILL - Në bazë të rezultateve të para të zgjedhjeve parlamentare në Hungari, fituese është partia kundër imigracionit e kryeministrit aktual Viktor Orban.

Duke shpallur fitoren në një fjalim në Budapest, ai tha se fitorja e partisë së tij Fidesz është "një mundësi për ta mbrojtur Hungarinë".

Gjatë fushatës për zgjedhjet e së dielës ai ishte përqendruar në qasjen kundër imigrantëve dhe përsëriti teorinë konspirative se Bashkimi Evropian, Kombet e Bashkuara dhe filantropisti George Soros duan ta shndërrojnë Hungarinë në "vend të imigrantëve".


Sipas rezultateve paraprake, Fidesz do të ketë 133 deputetë në parlamentin prej 199 vendesh. Ai e filloi fjalimin e tij para mbështetësve pak pas shpalljes së rezultateve paraprake me mesazhin e qartë: "Ne fituam". Ai i tha turmës së mbledhur se kemi krijuar një mundësi për ta mbrojtur Hungarinë. Një betejë e madhe është pas nesh. Ne kemi shënuar një fitore vendimtare. Kjo është fitorja e katërt e tij. Ai kishte drejtuar koalicionin qeverisës të udhëhequr nga Fidesz gjatë viteve 1998- 2002, para se të rikthehej në pushtet në vitin 2010. Fjalimet e tij para zgjedhjeve të së dielës kanë alarmuar Bashkimin Evropian dhe Kombet e Bashkuara si dhe kanë shtuar shqetësimet e grupeve për të drejtat civile për sulme ndaj medias dhe gjyqësorit.



BE: Hungaria t'i ruajë vlerat e bllokut pas fitores së Orbanit

BRUKSEL, 9 PRILL - Bashkimi Evropian i ka bërë thirrje Hungarisë të ndihmojë në ruajtjen e vlerave të bllokut, pasi kryeministri i krahut të djathtë, Viktor Orban, ka shpallur, siç është shprehur, fitoren historike në zgjedhjet e përgjithshme, duke fituar të drejtën për mandatin e tretë radhazi. "Bashkimi Evropian është bashkim i demokracive dhe vlerave", ka thënë zëdhënësi i Komisionit Evropian, Margaritis Schinas, duke shtuar se ruajtja e këtyre vlerave është "detyrë e përbashkët e të gjitha shteteve anëtare, pa përjashtim". Brukseli ka përsëritur përplasjet me Orbanin për politikën e tij anti-migrim dhe kundërshtimin e programit të BE-së për refugjatët.

Schinas ka thënë se presidenti i Komisionit Evropian, Jean-Claude Juncker, do t'i shkruajë më vonë Orbanit për t'ia uruar "fitoren e qartë" dhe se ai do të diskutojë me të për çështjet e interesit të përbashkët. Edhe kancelarja gjermane Angela Merkel e ka përsëritur fitoren e Orbanit dhe ka bërë thirrje për bashkëpunim pavarësisht prej dallimeve.



Sot me 10 prill 2018, në ora 11:00, në varrezat e fsh. Greme, mbahen homazhe në përkujtim të 9 vjetorit të ndarjes nga jeta të luftetarit e ushtarit të tri ushtrive, Ushtria Çlirimtare e Kosovës, UÇPMB dhe Ushtria Çlirimtare Kombëtare, të pavdekshmit Shaban Viqa - Baci! Ftohen shokët dhe bashkëluftëtarë e Bacit, të marrin pjesë në homazhe! Lavdi jetës dhe veprës së luftëtarit çlirimtar Shaban Viqa-Baci!

(Selatin Novosella, "Lëvizja Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve", I - II, ShBPK, Prishtinë, 2013)

Popullit t'i japësh aq sa ke e çka mundesh, jo t'i marrësh më shumë sesa i jep

- LRBSH-ja si një bërthamë e UÇK-së

50 vjet LRBSH! 50 vjet flamur!
50 vjet thirrje për bashkimin e shqiptarëve!
50 vjet burgje. 50 vjet qëndresë.
50 vjet përpjekje, sakrificë,
flijim për çlirim, për bashkim,
50 vjet histori Adem Demaçi



Riza GREIÇEVCI

Historia lindet dhe shkruhet me gjak, jo me parti politike, jo me marrëveshje e me kongrese. Historinë e shkruajnë pushka, trimëria dhe gjaku. Sapo ishte kthyer tribuni i LRBSH-së nga Mitrovica e Sremit, nga burgu jugo-ruso-titist-komunist, më 1962 (herën e dytë u burgos në vitin 1964 - 15 vjet burgim të rëndë, edhe në vitin 1975 u dënua me 15 vjet burgim të rëndë) formoi LRBSH-në.

Kjo nuk ishte një parti politike, as grup njerëzish të demokracisë së rreme evropiane, por ishte dhe vazhdoi të veprojë si Lëvizje gjithëpopullore. LRBSH-ja u quajt, lëvizje krejt për një qëllim tjetër, për një udhë tjetër të rezistencës dhe të mobilizimit. Formohet për një thirrje krejt ndryshe të veprimit dhe të mobilizimit:

Ishte Lëvizje e masave gjithëpopullore, Lëvizje e Bashkimit, që bënte thirrje për heqje dorë nga hasmëritë, nga gjakmarrja, ndalimi i shpërnguljes dhe migrimi i rinisë shqiptare atje ku kishte pak diell, kishte pak shpresë. Dhe, prijësi popullor i kësaj Lëvizjeje, në tregimin "Kthimi", shkruante: "Ju shkoni, shkoni, e lemni mue këtu qe dekterit' me rreh nj dell i qafës t'i ruaj vorret mos t'jav rreh kush... që kur t'des kësaj toke t'lume s'ka mi ardhë ranë xhenazja jeme se nuk e përbuza kurrë, nuk e lypa ma t'mirë!".

LRBSH-ja nuk thërriste për ndarjen e funksioneve: ministritë, kryeministër, agjenci biznesesh, për ndarjen e pushteteve, por bënte thirrje për rrëzimin e shtrigës sllavo-ruse të Jugosllavisë staliniste-titiste-serbo-çetnike, që kishte shkel në fyt dhe luante si macja me miun me një popull, që ishte specia më e vjetër në Evropë.

Dhe, ja, erdhi çasti historik: Shtator 1963. Në një dhomë të një kasolle të vjetër ishin tubuar djem që sytë iu shkrepnin xixël-lima trimërie, guximi, atdhetarie, qëndresë, tepër të gatshëm për t'u bërë kurban (ushtarë) të popullit të tyre për liri. Para veprimtarëve, me guxim, besë, shqiptari në gjakun e tyre, para një grushti shokësh më të devotshëm, doli dhe foli gjithëpopullor, djaloshi llapjan, poet e atdhetar, që zëri i tij u dëgjua në shtatë palë qiell, shtatë palë tokë: "Vëllazën! Kush do me u shkre e me u djeg me u ba shkruem e hi për liri: po nisemi sot! Po nisemi për të hyrë në zjarr për çlirimin e atdheut! Popullit t'i japim aq sa kemi e çka mundemi, dhe kurrë s'do t'i marrim më shumë se sa na takon! Po nisemi me LRBSH-në, si armën më të fuqishme, kah e kap qielli dhe toka! Me fat! Liri popullit!".

Të pranishmit në mbledhjen e formimit të LRBSH-së: Adem Demaçi, prijatar, Fazli Greiçevci, atdhetar dhe mësues nga ish-Sankoci i Drenicës, sot Flamuras, Zeqir Gërvalla, nga Lupçi i Llapit nxënës i Shkollës Normale në Prishtinë, Azem Beqiri nëpunës dhe poet, nga Dumnica e Podujevës, Abdyl Lahu, nxënës i Shkollës Normale të Prishtinës nga katundi Gllamnik i Besianës.

LRBSH-ja, jo, jo, Zot ruana, s'ishte një parti politike!

(Sepse: Kur jetës ia kërkova lirinë, ajo ma dha pushkën!)

Libri monografi historike për një revolucion gjithëpopullor "LRBSH", të autorit të dëshmuar dhe mjaft prodhimtar, Selatin Novosella, dëshmitar dhe pjesëtar i rrjedhave revolucionare gjithëpopullore ademdemaçiane, në dy vëllime të kësaj vepre, unë them edhe njëherë, monografi e Lëvizjes historike gjithëpopullore për çlirimin e trojeve etnike, për herë të parë para syrit të popullit sjell komplet edhe programin dhe statutin e LRBSH-së, komitetin e

LRBSH-së, aktvendimet e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, aktgjykime, aktvendimi i KZZ-së, i Gjykatës Supreme të Serbisë dega në Prishtinë, dhe shumë materiale të tjera. Formimi i Komiteteve të Qyteteve të LRBSH-së kishte për qëllim masivizimin e Lëvizjes dhe ishte arritur qëllimi me shpërndarjen e flamujve kombëtarë gjithandej Kosovës. LRBSH-ja kishte formuar edhe partinë e revolucionare për Bashkimin e Tokave Shqiptare me shtetin amë, ku planifikohesh edhe formimi i radhëve të armatosura, ku anëtari i saj, Metush Krasniqi burgoset dhe dënohet me 18 vjet burgim të rëndë. LRBSH-ja, jo, jo, zot ruana, s'ishte një parti politike! Ishte pasardhëse që nga Lidhja Shqiptare e Prizrenit, Rezistenca e Lëvizjes së Kaçakëve, në krye me ideatorin Hasan Prishtina, Shotë e Azem Bjetën, pasardhëse e Luftës Çlirimtare të Drenicës, dhe së fundit bërthamë. LRBSH-ja ishte pjesë e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës deri në fitoren madhështore, përzënien nga Kosova sojin çetnik të Shën Savës, dhe fitorja e lirisë, pavarësisë së Kosovës!

"Jo, Adem, bir, nana nazife një ditë do t'vdes, por nana shqipni nuk do të vdes!"

Po sjellim vërtet një shembull, jo për lëvdatë, Zot ruana, por një shembull i dashurisë shenjtërore të të birit ndaj krijesës, diell i njerëzimit, e cila me djep përkund krejt botën. Po sjell sot këtu, në 50-vjetorin edhe kujtimin dhe respektin e krejt

shqiptarisë për nënën Nazife, e cila për të vetmin djalë në vatër, Ademin, ishte edhe konsulente: Djali i drejtohet nënës: "Nana, Nazife! Tash më duhet të të tregoj edhe diçka: S'mund t'u them shokëve që të punojnë për atdhe dhe vet të rri e të shikoj anash.

Mirëpo, me ke djalë, një dritë jete, dhe ti e di, moj nanë, se pa lejen tane s'ka ba asgja në këtë jetë. Prandaj, nëse ti dëshiron, që unë të mbetëm me ty, ma thuaj qetash!".

Nëna Nazife, edhe pse ishte analfabete, ishte një filozofe, ishte një nënë luaneshë, ajo shkurt e shqip i dha përgjigje të vetmit djalë që kishte sjell në jetë: "Jo, Adem, bir, nana Nazife një ditë do t'vdes, por nana Shqipni nuk do të vdes! E, ti, Adem, biri i jem, le nëshpi nanën Nazife dhe ti kapju Nanës Shqipni! Kapju asaj nane që s'do të vdes kurrë, o të pastë nana!".

Or ti, njeri, mos u mërzit dhe mos u bëj aq budalla të jesh edhe aq smirëzi kur dikush ndriçon më shumë se ti!

Pa dyshim, kjo vepër madhore historike "LRBSH-ja", e hartuar me një përkushtim dhe profesionalizëm të rrallë, por edhe një vullnet për lakmi, nga pjesëtari i saj, Selatin Novosella, ishte, është dhe do të mbetet një faqe e ndritshme e historisë dhe e përpjekjeve të bijve më të devotshëm për çlirimin dhe bashkimin e atdheut të ndarë nga sejmenë të fuqive të mëdha të Evropës thjeshtë. Sot po shënojmë 50 vjet të kësaj

Lëvizjeje, 50 të zgjimit të popullit shqiptar, 50 vjet nga thirrja e zëshme e tribunit të kësaj Lëvizjeje, Adem Demaçi, me shokë, veçmas LRBSH-ja, pse vallë, deri me sot është anashkalar, është harruar, është lënë jashtë rrjedhave të ecejakeve të jetës sonë shoqërore politike e shkencore. Sa herë dhe kur u shënuar një tubim gjithëpopullor në Kosovë, Shqipëri apo diku tjetër për LRBSH-në? Sa përpjekje u bënë, dhe cilat janë rezultatet e kësaj përpjekjeje të historianëve, shkencëtarëve, publicistëve, atdhetarëve, politikanëve, e kohëve të fundit, cilat janë përpjekjet e Qeverisë dhe të shtetit të lirë të Republikës së Kosovës, për të ndriçuar, shënuar së paku modestish këtë Jubile, veprimtarinë e pamohueshme revolucionare e gjithëpopullore për çlirim dhe bashkim të shqiptarëve.

Pse deri më sot nuk u publikuan, nuk i zbardhen, dokumentet dhe dëshmitë e veprimtarisë së kësaj Lëvizjeje gjithëpopullore? Ku janë dhe çka presin Instituti për Histori, ASHAK-u i Kosovës? Sa akademi, sa tryeza, sa tubime, sa herë, ku, dhe kur u përkujtua në mënyrë të organizuar kjo Lëvizjeje, kjo epokë e ndritshme e historisë kombëtare, pse u mohua, u harrua, u hesht kontributi historik e kombëtar LRBSH-së? Një të mos e harrojmë: Or ti, njeri, mos u mërzit dhe mos u bëj aq budalla, të jesh edhe aq smirëzi, inatçor i sëmurë mëndësh, kur dikush ndriçon më shumë se ti! Lavdi LRBSH-së! Lavdi UÇK-së! Lavdi e përjetshme dëshmorëve të Kosovës! (Fund)



Leonardo DiCaprio dhe e dashura "ikin" në Japoni



Duket se gjërat po bëhen serioze në mes të aktorit 43-vjeçar, Leonardo DiCaprio dhe modelueses 20-vjeçare, Camila Morrone. Çifti bashkë me familjarë dhe miq kanë udhëtuar drejt Japonisë. Ishte modeluesja ajo që ka postuar një fotografi nga ky udhëtim,


ku shihet bashkë me të ëmën dhe miken e saj, modeluesen Isabella Peschardt. Megjithatë, në asnjërën nga postimet e saj nuk shihet DiCaprio. DiCaprio dhe Morrone janë parë së bashku në muajin dhjetor dhe që atëherë janë në lidhje.

Kate Hudson po pret fëmijën e tretë



Aktorja e famshme Kate Hudson është në pritje të fëmijës së tretë. Ylli i Hollywoodit është shtatzënë me të dashurin Danny Fujikawa dhe janë në pritje të një vajze. Aktorja ka dy

djem nga dy lidhje të marrëdhënies të mëparshme. Ajo ka konfirmuar lajmin me anë të një video në rrjetin social "Instagram". 38-vjeçarja dhe Fujikawa janë në një lidhje me njëri-tjetrin për më shumë se një vit.



Rita Ora, sportive nëpër rrugët e Nju Jorkut

Rita Ora njihet për stilin unik. Këngëtarja e famshme me prejardhje nga Kosova

ka dëshmuar edhe këtë herë se ka guxim në veshje. Ajo është shfaqur në Nju Jork me veshje sportive të veçantë.



Lisa dhe Jason, ende të lumtur

Lisa Bonet dhe Jason Momoa numërojnë 13 vjet bashkë, por u martuan tek vitin e kaluar. Ata u shfaqën po aq të afërt edhe në daljen e tyre më të fundit publike, në ngjarjen e "Cartier"-it në San Franciso këtë të enjte. Aktorja 50-vjeçare së fundi në një intervistë për "Porter Edit" ka treguar se janë bashkë që prej ditës së parë që ishin takuar dhe janë të lumtur së bashku.



Lufta verbale Britani-Rusi, kush është Sergei Skripal?

Kush është Sergei Skripal, agjenti i helmuar me gaz nervor që e ka ftohur keq marrëdhënien jo vetëm mes Britanisë së Madhe e Rusisë, por edhe perëndimit e Kremlinit? Kur e pse ndodhi kalimi i tij tek britanikët?

Emri i Sergei Skripal, agjentit rus që u bë agjent i dyfishtë duke punuar edhe për britanikët u fut në fokusin e shërbimit sekret të inteligjencës, ndërsa ai punonte në Madrid tek zyra e atashut ushtarak të Moskës, për shërbimin sekret ushtarak të Rusisë, GRU.

Pse ndërroi Skripal krahun e u bë agjent i dyfishtë?

Sergej Skripal lindi në Kaliningrad në vitin 1951, pas shkollimit ai iu bashkua

Sipas The Times, Skripalit i kërkoheshin informacione dhe detaje për koordinatat dhe vendndodhjen e agjentëve ruse kur ata zhvillonin takime. Me gjasë informatat përfshinin agjentë në vende të ndryshme europiane. Më vonë Skripal për shkak të problemeve shëndetësore u dërgua në Moskë të punonte në shtabin e GRU. I kthyer në Rusi ai u diagnostikua me diabet. Megjithëse Sergei Skripal pushoi së punuari për GRU në vitin 2000, ai vazhdoi të mbante një punë në qeverisjen lokale në Moskë duke qenë kështu i aftë të



Skripal FSB-së. Shërbimi sekret rus, FSB e akuzoi atë se është rekrutuar nga shërbimi inteligjent britanik në vitin 1995. Dy vite më vonë Skripal u dënua për „tradhti të lartë në formë të spiunazhit” me 13 vite burgim në një burg të sigurisë së lartë. Agjenti i dekonspiruar mori një dënim relativisht të lehtë për shkak të bashkëpunimit me autoritetet. Skripal pati fat, kur 10 agjentë rusë u dërguan në SHBA pas zbulimit të tyre si pjesë e një rrjeti të fshehtë të spiunëve, që paraqiteshin si amerikanë normalë në këtë vend.

Tragjedi personale

Ai ishte një katër operativët perëndimore, që u dërguan në drejtimin e kundërt, i falur nga

presidenti i atëhershëm rus, Dmitri Medvedev. Lirimi i Skripalit u bë me ndihmën e qeverisë britanike, prandaj Britania e Madhe ishte vendi ku ai u vendos. Ai bleu një shtëpi në Salisbury, por në vitet e mëvonshme iu desh të përballlej me disa tragjedi personale. Gruaja Liudmilla ndërroi jetë nga kanceri në vitin 2012, djali i vdiq në korrik të vitit të kaluar në moshën 43 vjeçare gjatë një vizite në Shën Peterburg. Ende nuk janë sqaruar rrethanat e vdekjes së tij. Po ashtu edhe vëllai i tij 68 vjeçar, Valery, që shërbeu në ushtrinë ruse, ndërroi jetë dy vjet para se ish-agjenti të helmohej me vajzën e tij 33-vjeçare Yulia në Salisbury.

(gazeta-Shqip.com) / DW

ushtrisë, para se të kalonte tek shërbimi sekret ushtarak, GRU. I vendosur në Maltë ai tregoi aftësi si agjent, duke bërë që më vonë t'i ofrohet një post në kryeqytetin spanjoll, Madrid. Megjithëse ai ishte zbuluar si një aset i mundshëm edhe për shërbimin sekret spanjoll, Skripas përfundoi si agjent i MI6, pikërisht në Spanjë. Kjo ndodhi në epokën e Boris Yeltsinit, kur paratë rridhnin me pikatore në Rusi. Zyrat e shërbimit sekret rus jashtë vendit shpesh nuk paguheshin për periudha të gjata. Sipas raporteve, arsytet e kalimit të tij në krahun britanik ishin financiare. Gazeta britanike The Times ka njoftuar se MI6 i dha spiunit rus pseudonimin “Fortwith.”

siguronte informacione të rëndësishme.

Kapja nga rusët

Kërkesa për para ka qenë me sa duket faktori konstant i angazhimit të tij. Nga Moska, ai vizitonte rregullisht Malagan, ku MI6 i kishte siguruar një shtëpi, ku merrte pagesat. Nëse ai nuk mundej, shkonte bashkëshortja e tij, Liudmilla.


Skripal u kap nga autoritetet në vitin 2004. Ai ishte jashtë shtëpisë së tij në rajonin e Krylatskoyes kur u fut në një mikrobus me xhama të errët, i sapo kthyer nga një vizitë në Britaninë e Madhe. „Ju më mundët”, thuhet se i ka thënë



E rrallë

Arrestohet babai që mbajti të birin në kafaz për më shumë se 20 vjet

Në Japoni policia ka arrestuar një prind për të cilin pretendohet se e mbante të birin e tij në një kafaz prej druri për më shumë se 20 vjet, me arsyetimin se ishte me aftësi të kufizuara mendore. Djali i Yoshitane



Yamasakit tani është 42-vjeçar. Përveç kurrizit të lakuar ai është në gjendje të mirë shëndetësore.

BARSOLETA E DITËS



Një hajdut shkon në pazar për t'i shitur rrobat që kishte vjedhur, por një hajdut tjetër ia vjedh. Në darkë e shoqja e shih të mërzhitur dhe e pyet: - Nuk fitove gjë? Hajduti ia kthen: Këtë herë i shita me çmimin që i kam blerë.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetem gjatë vikendit në ora 14:30

“BLACK PANTHER” 3D (PG-13)

Aksion/Aventurë/Fantastiko-Shkencor; 2 orë 15 min

Rolet: Chadwick Boseman, Angela Basset, Michael B. Jordan, Lupita Nyong'o, Martin Freeman, Forest Whitaker, Andy Serkis, etj.
Regjia: Ryan Coogler



FOTO E DITES



Një varkë peshkimi palestinez lundron në bregun jashtë qytetit të Gazës. /Photo: AP/

Në ora 17:00

“PETER RABBIT”

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 33 min

Rolet: James Corden, Rose Byrne, Domhnall Gleeson, Sam Neill, Daisy Ridley, Elizabeth Debicki, Margot Robbie, etj.

Regjia: Will Gluck



Në ora 19:00

“PACIFIC RIM UPRISING” (PG-13)

Aksion/Aventurë/Fantastiko-Shkencor; 1 orë 51 min

Rolet: John Boyega, Scott Eastwood, Jing Tian, Cailee Spaeny, Rinko Kikuchi, Burn Gorman, Adria Arjona, Charlie Day, etj.
Regjia: Steven S. DeKnight



Në ora 21:00

“RED SPARROW” (R)

Mister/Triller; 2 orë 25 min

Rolet: Jenifer Lawrence, Joel Edgerton, Matthias Schoenarts, Jeremy Irons, Mary-Louise Parker, Charlotte Rampling, etj.
Regjia: Francis Lawrence



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.

E jashtëzakonshme

Karriget që rriten në pemë

Në një qytet të Anglisë degët e pemëve janë të vendosura në mënyrë të çuditshme. Nëse i shikon nga afër vë re se degët e tyre kanë formën e karrigës me kokë poshtë. Secila prej 'karrigëve pemë' zgjat shtatë deri në nëntë vjet për t'u rritur. Vlera e një karrige të tillë është 5 000 paund.



DASHI

Do t'ju lindin disa probleme në fushën profesionale sot që do të duhet me doemos t'i zgjidhni. Jeni në udhëkryq dhe po tentoni ta gjeni drejtimin.



DEMI

Sot jeni në fushë të hapur me kundërshtarët tuaj. Duhet të keni kujdes nga ata që ende nuk janë shfaqur përballë jush.



BINJAKËT

Do ta keni të vështirë t'i keni nën vëzhgim personat me të cilët keni marrëdhënie pune. Shumë prej tyre janë të prirë të neglizhojnë.



GAFORRJA

Nuk mund t'i gënjeni sot ata persona që rrinë pranë jush. Edhe pse po tentoni t'i fshihni ndjenjat tuaja dikush, do të zbulojë çfarë ju shqetëson.



LUANI

Edhe pse nuk po e pranoni, keni nevojë të keni pranë vetes një person të caktuar që ju ndryshon humorin dhe ju kthen buzëqeshjen.



VIRGJËRESHA

Mungesa e besimit ju ka bërë më të ftohtë në marrëdhënie me të tjerët. Jo me të gjithë mund të mbani të njëjtin qëndrim indiferent.



PESHORJA

Tregohuni më të hapur me të tjerët dhe ata do të bëjnë çmos t'ju tregojnë mirënjohje. Zgjidhni personat që besoni në rrugën tuaj.



AKREPI

Duhet ta vini veten në vend të dikujt tjetër që të mund të gjykoni një situatë të caktuar. Jo gjithmonë gjërat janë ashtu siç duken.



SHIGJETARI

Problemet tuaja zgjidhni përpara se të jetë shumë vonë. Dikush do të luajë një lojë të pistë nga e cila do të dilni jo pak të lënduar.



BRICJAPI

Të konkretizoni atë që keni në mendje sot nuk do të jetë shumë e vështirë. Mjaft të flisni me njerëzit e duhur, sepse gjërat do të realizohen.



UJORI

Sot mos kaloni në sulm kur t'ju pyesin për gjëra shumë të thjeshta. Nervozizmi juaj do të lë të kuptohet se ka diçka që nuk shkon.



PESHQIT

Nuk keni mundur t'u jepni përgjigje dyshimeve të shumë personave sot. Nëse e lini të kalojë këtë situatë, gjërat thjesht do të mbeten pa sqaruar.



QENDRA SPORTIVE

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

MAN CITY - LIVERPOOL

1

ROMA - BARCELONA

3+

BLACKPOOL - NORTHAMPTON

1

Pingpongu promovohet në Sheshin 'Zahir Pajaziti'

"Qëllimi kryesor i shënimit të kësaj dite është promovimi i sportit të pingpongut. Është kërkesë nga Federata Botërore që të organizohet në vende të ndryshme si në ndonjë shesh, rrugë kryesore të frekuentuar, plazh apo mal, në një vend më të jashtëzakonshëm sesa sallat ku praktikohet pingpongu", ka thënë Kastriot Orana

PRISHTINË, 9 PRILL - Federata e Pingpongut e Kosovës ka filluar një aktivitet të hënën në Sheshin "Zahir Pajaziti" në Prishtinë për nder të Ditës Botërore të kësaj kategorie sportive. Në këtë aktivitet kanë marrë pjesë qytetarë të shumtë të cilët po promovonin sportin e pingpongut e disa ishin për herë të parë duke provuar këtë sport.

Kastriot Orana, anëtar i Bordit të Federatës së Pingpongut, deklaroi se Dita Botërore e Pingpongut është më 6 prill por, për shkak të motit me shi, Federata e Pingpongut ka shtyrë këtë organizim për të

hënën. "Qëllimi kryesor i shënimit të kësaj dite është promovimi i sportit të pingpongut. Është kërkesë nga Federata Botërore që të organizohet në vende të ndryshme si në ndonjë shesh, rrugë kryesore të frekuentuar, plazh apo mal, në një vend më të jashtëzakonshëm se sa sallat ku realisht praktikohet pingpongu. Ne me anë të këtij aktiviteti dëshirojmë ta afrojmë pingpongun më afër qytetarëve, që qytetarët ta kenë mundësinë të luajnë nga afër me profesionistë të pingpongut si dhe të luajnë mes vete", ka thënë Orana.



E pranishme në këtë aktivitet ishte edhe lojtarja aktive e përfaqësueses së Kosovës në pingpong, Iliriana Haliti. Ajo u shpreh se pingpongu është

një sport me shumë përfitime dhe i bën mirë gjithsecilit, prandaj i ftoi të gjithë ta praktikojnë këtë sport, raporton "KP". "Jemi duke u

munduar t'i bëjmë promovim sa më të mirë të mundur pingpongut dhe t'i tërheqim qytetarët", ka thënë Haliti.

'Euronews' shkruan për Loriana Kukën

PRISHTINË, 9 PRILL - Paraqitjet fantastike të xhudistes nga Kosova, Loriana Kuka, në turneun Grand Prix në Antalya të Turqisë, ku ajo u stolis me medalje të artë në kategorinë e saj, kanë bërë që "Euronews" ta zgjedhë atë lojtaren e ditës në këtë turne. "Loriana Kuka e Kosovës ishte lojtarja jonë e Ditës. Një hedhje (Osotogari) e shkëlqyer kundër Natalie Powell bëri që ajo të kalojë në gjysmëfinale, ku një hedhje tjetër madje edhe më e mirë (Uchaimata) e dërgoi atë në finale për medalje të artë në kategorinë nën 78 kilogramë", shkruan "Euronews". Aty ajo do të përballej me xhudisten ukrainase Anastasiya Turchyn. Pati



dramë të jashtëzakonshme në çastet e fundit teksa Kuka ia doli të shënojë pikë nga një kundërsulm në fishkëllimën dhe duke bërë atë, ajo rrëmbeu medaljen e artë në garën e saj të parë ndonjëherë në turneun botëror të xhudos (World Judo tour). Në fund Euronews pyet: Si 21-vjeçare, a mund të jetë ajo sensacioni i radhës nga vendi i saj?

Prishtina e fitoi derbin e kryeqytetit

PRISHTINË, 9 PRILL - Prishtina ka shënuar fitore në ndeshjen derbi të skuadrave nga kryeqyteti si mysafire e Flamurtarit, me rezultat 2-0, në ndeshjen që është zhvilluar të hënën në stadiumin e skuadrës kuqezi dhe e cila e përmbylli javën e 26 në Vala Superligë. Me këtë fitore Prishtina ka arritur në kuotën e 47 pikëve, duke e ruajtur hapin me skuadrën kryesuese, Dritën, që ka tri pikë më shumë. Prishtinën e kaloi në epërsi Arago Jamal në minutën e 13 me një gjuajtje nga distanca, derisa fitoren e bardhekaltërve e



vulosi Basid Khalid në minutën e 87, kur shënoi nga brendësia e zonës për rezultatin përfundimtar 2:0. Pas kësaj humbjeje Flamurtari edhe më tutje ia vështirëson vetes garën për t'iu shmangur rënies nga elita.

Sonte mësohen gjysmëfinalistët e parë në Ligën e Kampionëve

MANCHESTER, 9 PRILL - Sonte (e martë) zhvillohen dy ndeshjet kthyes të çerekfinales së Ligës së Kampionëve dhe me këtë rast do të mësohen skuadrat që kualifikohen në gjysmëfinale. Liverpooli ka

krijuar avantazh të madh nga ndeshja e parë në "Anfield Road" ndaj Manchester Cityt (3-0), por futbollistët e Pep Guardiols nuk do të dorëzohen dhe do të kërkojnë të bëjnë mrekullinë dhe ta

shkrijnë epërsinë e tri golave. Ndeshja tjetër në mes të Romës dhe Barcelonës ka përfunduar 4-1 në "Camp Nou" dhe vështirë do ta ketë Roma të bëjë befasinë në këtë përballje.

TË MARTËN TAKOHEN:
20:45 Manchester City-Liverpool
20:45 Roma-Barcelona



Pensionohet Capello

ROMË, 9 PRILL - Fabio Capello ka njoftuar se nuk do ta menaxhojë më asnjë ekip. Italiani ka vendosur të pensionohet nga roli i trajnerit. 71-vjeçari kishte udhëhequr Milanin drejt katër titujve në Serinë A dhe një Ligës së Kampionëve në vitet '90, para

se ta merrte drejtimin e Real Madridit, klub me të cilin fitoi La Ligën në edicionin e tij të parë, para se marrëdhëniet e tij me pronarin e klubit të prisheshin. Ai më pas u rikthye te Milani dhe më vonë drejtoi edhe Romën dhe Juventusin, duke fituar ligën me të dyja

ekipet, edhe pse dy prej tyre të fituara me torinezët i ishin marrë për shkak të skandalit "Calciopolo". Italiani mori për herë të dytë drejtimin e Real Madridit dhe fitoi përsëri një titull të ligës, pastaj shkoi te përfaqësuesja angleze, të cilën e udhëhoqi në periudhën

2008-2012. Ai më pas drejtoi Rusinë drejt Kupës së Botës në vitin 2014, por u shkarkua pas një kampanje të dobët në Kampionatin Evropian të vitit 2016. Së fundmi ai ishte pjesë e Jiangsu Suning, por pas një ecurie të dobët të rezultateve u shkarkua në muajin mars.



Klopp, Guardiola: Nuk ka trajner dhe ekip të përsosur

LIVERPOOL, 9 PRILL - Jurgen Klopp ka folur në prag të çerekfinaleve të kthimit me Liverpoolin në "Etihad", pasi mesjavën e kaluar doli kryelartë nga "Anfield", me fitoren 3-0, raporton "Telesport". Një avantazh i konsiderueshëm për të shkuar në gjysmëfinale, por për trajnerin gjerman ende nuk ka mbaruar, sidomos kur flitet për kompeticione të tilla si Champions. "Është e arsyeshme të thuhet se ne nuk ishim favoritë para se të luanim në fazat me eliminim të drejtpërdrejtë të Ligës së Kampionëve. E njëjta gjë edhe para raundit çerekfinale kundër Manchester Cityt. Kur humbëm këtu 5-0, në fillim të sezonit, të gjithë e panë cilësinë e Manchester Cityt, të trajnerit më të mirë në botë. Por, nuk ka asnjë ekip të përsosur në botë. Ky është futbollit dhe ke gjithmonë mundësi për t'u përgjigjur. Liga e Kampionëve është konkurrenca më e mirë në botë dhe kjo është arsyeja pse është kaq e vështirë për t'i kaluar




raundet me sukses. Dy humbjet e Manchester Cityt? Edhe ata luajnë me qenie njerëzore, falë Zotit. Kanë pasur dy rezultate të këqija, që askush nuk i priste", ka thënë Klopp. "Nëse e sheh ndeshjen me Manchester Unitedin, ata kishin pak fat. Pastaj, Manchester City nuk i shfrytëzoi rastet e krijuara, sepse mund të kishte shënuar gjashtë gola në pjesën e parë. Skuadra e Guardiola është cilësi, nuk është

një surprizë për ne. Lëndimi i Salah? Nuk jam i sigurt nëse do të jetë në dispozicion. Tani për tani do të thosha se është më shumë 'jo', por do të duhet ta shohim reagimin në trajnim dhe ta marrim vendimin e duhur", ka deklaruar Klopp, i cili ka shtuar se netët evropiane për Liverpoolin janë të veçanta, pasi nuk është skuadër më me përvojë sesa Manchester City në Ligën e Kampionëve.

Toronto e Golden State fitojnë pa probleme

TORONTO, 9 PRILL - Kampionët e Golden States korin një fitore të lehtë në NBA, duke mundur 117-100 Phoenixin në fushën e këtij të fundit, ndeshje e dominuar nga basketbollistët e ekipit të Warriorsit. Suksesi i 58 sezonal për Golden State mban firmën e Thompsonit, autor i 34 pikëve. Fiton edhe skuadra e Urtah Jazzit, që mundi 112-98 Lakersin në Los Anxhelos, sfidë ku miqtë bënë ligjin në parket gjatë gjithë kohës. Mitchell me 28 pikë e Inglesi me 22 ishin liderët në fushë për ekipin e Jazzit. Humbet skuadra e



Bostonit, që tashmë mendon më shumë për "play-off"-in. Edhe pse Celticsi dominoi në ndeshje, në fund u mund 112-106 nga Atlanta, me Princen që bëri diferencën për miqtë, autor i 33 pikëve. Në krye të

renditjes në Lindje qëndron Toronto që, edhe pse ka siguruar vendin e parë, nuk ndalet. Kanadëzët fituan 112-101 ndaj Orlandos, duke regjistruar suksesin e 59 sezonal, që erdhi nga duart e Miles, autor i 22 pikëve.

REZULTATET

Boston - Atlanta	106-112
Charlotte - Indiana	117-123
Philadelphia - Dallas	109-97
Memphis - Detroit	130-117
Lakers - Utah Jazz	97-112
Toronto - Orlando	112-101
Phoenix - Golden State	100-117

SHKURT

Lenjani në formacionin e javës në Zvicër

Ermir Lenjani ka vazhduar të luajë mirë në futbollin zviceran. Mbrojtësi i Kombëtares së Shqipërisë ka qenë vendimtar në fitoren e Sionit 0-2 në udhëtim te Lausanne. Lenjani asistoi fillimisht në momentin që Sioni fitoi penalltinë në minutën e 53-të. E nëntë minuta para fundit të ndeshjes, kamenicasi përsëri ishte protagonist kur bëri një asistim mjeshtëror për Carlitosin që shënoi për 0-2. Falë kësaj fitore Sioni ka shtuar dukshëm gjasat për të mbijetuar në elitën e futbollit zviceran. Paraqitja e jashtëzakonshme ndaj Lausannes ka bërë që Lenjani të futet edhe në formacionin e javës në Zvicër nga "Blick". Për Lenjanin kjo është java e tretë radhazi që futet në formacionin e javës në Zvicër. 28-vjeçari ka arritur të shënojë dy gola në kampionat dhe të bëjë pesë asistime.

Vettel: Rrezikova të përfundoj i treti

Sebastian Vetteli u djersit shumë për ta arritur fitoren e 49 në garën e 200 metrave në karrierë. Një fitore që gjermani do ta kujtojë gjatë. "Mercedes ishte shumë i fortë dhe në fundin e garës kishte tjetër ritëm me gomat e ndërmjetme. Gomat e mia të buta pothuajse kishin mbaruar por, për fat të mirë, mbaruan dhe xhirot dhe arrita të kaloj finishin përpara tyre", ka thënë Vetteli. Më pas piloti i Ferrarit ka komplementuar edhe kundërshtarët që zgjedhën strategjinë e duhur. "Kur dolëm nga bokset e dinim që do të kishim një ritëm gare më të mirë, por ata zgjedhën strategjinë më të mirë. Rrezikuam shumë në fund dhe mund ta mbyllnim garën në vendin e tretë", ka deklaruar Vetteli.

Bayerni i ofron kontrata Riberys dhe Robbenit

Bayern Munchen e ka marrë një vendim të papritur. Gjiganti gjerman dëshiron të mbajë në ekip Franck Ribery dhe Arjen Robben. Sipas "Bild"-it, Bayerni do t'u ofrojë kontrata të reja lojtarëve. Anëtarët do të jenë të lirë në fund të sezonit, por duket se s'do të lëvizin nga "Alianz Arena".

Torresi njofton për largim nga Atletico

Javët e fundit të sezonit të Atletico Madridit do të jenë të fundit edhe për Fernando Torresin në këtë klub, pasi vetë spanjulli njoftoi se do të largohet nga klubi sapo kontrata t'i mbarojë në verë. Ishte viti 1995 kur spanjulli nënshkroi për herë të parë me akademinë e Atletico, ndërsa debutoi për ekipin e parë në vitin 2001, para se të largohej më 2007 dhe të kthehej më 2016 për ta kaluar edhe një periudhë tjetër te klubi i ëndrrave. "Kur mbërrita në moshën 10-vjeçare, gjithmonë mendoja se Atletico do të ishte shtëpia ime. E kam përjetuar një Atleti për të cilën gjithmonë kam ëndërruar. Do të doja ta shfrytëzoj këtë rast për të njoftuar se ky do të jetë sezoni im i fundit në klub. Nuk ka qenë vendim i lehtë. Më ka kushtuar shumë për ta marrë", ka thënë Torres.

Mou ofron Pogban dhe Martialin për Neymarin

Një lajm mjaft i bujshëm në lidhje me merkaton e sezonit të ardhshëm vjen nga Anglia. Mediet britanike raportojnë se Jose Mourinho po kërkon të sjellë në Manchester yllin brazilian të PSG-së, Neymar Junior. Për t'i bindur francezët, drejtuesit e 'dajve të kuq' kanë ndërmend të ofrojnë pikërisht dy prej yjeve francezë, Paul Pogban dhe Anthony Martialin. Tashmë është e qartë se Neymarin nuk është i kënaqur me aventurën franceze, teksa në garë për shërbimet e tij ka hyrë prej kohësh edhe Reali i Madridit. Gjithsesi, shkëmbimi me Pogban dhe Martialin do të ishte shumë më interesant dhe i pranueshëm për PSG-në, që me këta të dy mund të zëvendësojë edhe brazilianin, por edhe Marco Verrattin, që duket gjithashtu i destinuar për t'u larguar.



**Republika e Kosovës
Komuna e Gjilanit**

Republika Kosova Opština Gnjilane, Republic of Kosovo Municipality of Gjilan, Gilan Belediyesi
Duke u bazuar në dispozitat e Nenit 17 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike 03/L-087, Komisioni Komunal i Aksionarit të NPL "Tregu" S.H.A Gjilan shpall:

KONKURS

Për zgjedhjen e një (1) anëtar (e) të Bordit të Drejtorëve të Ndërmarrjes Publike Lokale NPL "Tregu" S.H.A Gjilan,
Mandatit të Drejtorëve të zgjedhur është sipas ligjit mbi NP.

I. KUALIFIKIMET DHE PËRGADITJA PROFESIONALE

Sipas nenit 17, pika 17.3 të Ligjit mbi ndërmarrjet publike, një kandidat për t'u zgjedhur drejtor në Bordin e Drejtorëve duhet t'i plotësojë këto kushte:

- Të jetë person që ka integritet, të mos ketë çfarëdo shkelje fiduciare ndaj personave tjerë fizik dhe juridik.
- Të ketë përgatitje superiore;
- Të ketë së paku 5 vjet përvojë pune në nivel të lartë të menaxhmentit, në fushën e administrimit të biznesit, të financave korporatave, të financave, të menaxhimit të thesarit, të bankave, konsulentë në biznes ose industri, ose nga një fushë tjetër e shkencave – të ketë qenë kontabilist publik, jurist i kualifikuar, ose anëtar i kualifikuar i një profesioni tjetër, i cili ndërldhet ngushtë me veprimtarinë afariste të NP-së.

Kompensimi i Drejtorëve të Ndërmarrjes Publike NPL "Tregu" S.H.A Gjilan

Kompensimi i Drejtorëve të Bordit të NPL "Tregu" S.H.A Gjilan do të bëhet në pajtim me dispozitat e nenit 20, pika 20.2 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike.

• KUSHTET

Kandidati (ja) ka të drejtë të zgjedhet në Bordin e NPL-se nëse:

- Nuk kanë qenë të dënuar dhe nuk janë nën hetime nga ndonjë Gjykatë kompetente;
- Nuk kanë shkelur kodin etikës apo standardet e sjelljes profesionale, përveç nëse një denim i tillë është ndryshuar nga një Gjykatë, ose organ tjetër i ankesave;
- Nuk ka bërë përgënjeshtime material nën çfarëdo dëshmie nën betim, nuk ka qenë në post menaxhues të ndonjë kompanie që ka falimentuar gjatë dhjetë (10) viteve të fundit.

Kandidati nuk mund të zgjedhet drejtor në Bordin e NPL "Tregu" S.H.A Gjilan, nëse:

- Aktualisht është zyrtar (në kuptim të nenit 21 të Ligjit mbi ndërmarrjet publike), menaxher i ndërmarrjes përkatëse, ose cilëso nga filialet e saja;
- Ka shërbyer si menaxher i ndërmarrjes publike përkatëse, ose cilëndo nga filialet e saja Brenda pesë (5) viteve të kaluara;
- Aktualisht ka, ose gjatë tri (3) viteve të kaluara ka pasur çfarëdo marrëdhënie material afariste (përveç si konsumator individual i shërbimit të ndërmarrjes publike) me ndërmarrjen publike përkatëse, ose cilëndo nga filialet, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë;
- Është aksionar, drejtor ose zyrtar në një shoqëri tregtare ose person tjetër juridik, i cili ka marrëdhënie material afariste me ndërmarrjen publike përkatëse;
- Pranon ose ka pranuar brenda tri (3) viteve të kaluara kompensimin shtesë nga ndërmarrja publike përkatëse, ose nga cilado filial e saj (përveç honorarit të drejtorit ose kompensimit stimuluës të përcaktuar me nenin 20.1 të Ligjit mbi ndërmarrjet publike, ose është anëtar në skemën pensionale të ndërmarrjes publike përkatëse, ose të cilëndo nga filialet e saja;
- Përfaqëson një aksionar, i cili posedon mbi dhjetë përqind (10 %) të aksioneve votuese në ndërmarrjen publike përkatëse;
- Ka shërbyer në Bordin e drejtorëve të ndërmarrjes publike përkatëse më shumë se nëntë (9) vite nga dita e parë e zgjedhjes së tij;
- Është i afërm i shkallës së tretë (siç është konstatuar në përputhje me përkufizimin e interesit financiar në nenin 2 të Ligjit mbi ndërmarrjet publike), i cili do person që i takon cilëso nga kategoritë e sipërpërmendura;
- Është zyrtar, drejtor ose aksionar, ose ka një interes financiar në një shoqëri tregtare që konkurron me ndërmarrjen, ose është menaxher i lartë zyrtar, drejtor ose aksionar (i cili posedon më shumë se dy përqind (2 %) të të drejtave të votimit), ose ka një interes të konsiderueshëm financiar në cilëndo nga shoqëritë tregtare që konkurrojnë në ndërmarrjen;
- Është ose në çfarëdo kohe gjatë periudhës 36 mujore para datës së aplikimit, ka qenë zyrtar i zgjedhur, i emëruar politik ose bartës i një posti udhëheqës ose vendimmarrës në një parti politike;
- Ka çfarëdo konflikt të interesave, që për nga natyra, do të shkaktojnë që ky person të mos jetë në gjendje që në mënyrë efektive, me besnikëri, në mënyrë të pavarur dhe objektive t'i përmbush detyrat e tij përgjegjëse ndaj aksionarëve dhe ndërmarrjes publike.

• INFORMATË PËR PROCEDURËN E KONKURIMIT

Kandidatët, për anëtarë të Bordit të Drejtorëve të Ndërmarrjes Publike Lokale NPL "Tregu" S.H.A Gjilan duhet t'i dorëzojnë dokumentet e mëposhtme:

- CV- në;
- Letërmotivimin;
- Deklaratën nën betim (formularin i cili plotësohet në momentin e dorëzimit të dokumentacionit);
- Dëshminë e kualifikimit profesional;
- Dëshminë mbi përvojën e punës;
- Certifikatën që nuk është nën hetime dhe;
- Ekstraktin e lindjes.

Aplikuesi duhet të përgatis deklaratën nën betim, në të cilën deklaron se ai/ajo i përmbush kushtet e kualifikimit; pavarësin edhe përgatitjen profesionale çdo përgënjeshtim material, qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca, ose ndryshim material nga informatat e dhëna në deklaratën e sipërpërmendur do të rezultojë me diskualifikimin e menjëhershëm.

Dokumentacioni duhet të dorëzohet në zarf të mbyllur dhe dorëzohet në Qendrën për Shërbim të Qytetarëve, ish-Bankosi Nr.1, Komuna e Gjilanit

Dokumentacioni i dorëzuar kopje nuk kthehet. Originali mund të kërkohet gjatë intervistimit.

Do të kontaktohen vetëm kandidatët e përzgjedhur për intervistë.

Informatat shtesë mund të sigurohen përmes e-mail:

komisionikomunaliaksionareve@gmail.com

Afati i konkursit është i hapur 21 ditë nga dita e publikimit në gazetë ditore, web faqen zyrtare të Komunës, në tabelën e shpalljeve, duke filluar prej 10/04/2018 deri më 01/05/2018

Komisioni Komunal i Aksionarit të NPL "Tregu" S.H.A Gjilan

Data 10.04.2018



**Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo**

**Opština Gnjilane
Municipality of Gjilan
Gilan Belediyesi**

Na osnovu odredaba clana 17 Zakona o javnim preduzecima 03/L-87, Opštinska komisija akcionara JLP "Tregu" A.D.Gnjilane objavljuje:

KONKURS

O biranju jednog (1) clana Borda direktora u Lokalnom Javnom Preduzeću JLP "Tregu" A.D. Gnjilane

Mandat branih direktora je prema zakonu o javnim preduzecima.

• KVALIFIKACIJA I STRUCNA SPREMA

S hodno clana 17, tacka 17.3 zakna o javnim preduzecima, i jedan kandidat da bi se izabrao direktor u bordu treba ispunjavati sledece uslove:

- Da bude osoba koja ima integritet, da ne bude imao fuicijarnu povredu prema fizickim i drugim pravnim licima;
- Da poseduje strucnu spremu;
- Da ima najmanje pet godine radnog iskustva na visokom nivou menadzmenta, u oblasti administriranja biznisa, finansija korporacija menadziranja riznice, banaka, konzulencu u biznisu ili industriju ili druge oblasti nauka-knjigovodstvo, pravnik ili clan kvalifikovan druge profesije povezano usko sa delatnost JP.

Naknadjivanje direktora JP. "Tregu" A.D.Gnjilane.

Naknadjivanje direktora Borda JLP "Tregu" A.D.Gnjilane vrsice se u skladu sa odredbama clana 20., 20.2 zakona o javnim preduzecima.

II KVALIFIKACIJE I STRUCNA SPREMA

Kandidat ima pravo da se bira u Bordu JLP ukoliko:

- nisu kaznjeni i nisu pod istragom od nekog nadležnog suda,
- nisu povredili kod etike ili standarde profesionalnog ponasanja osim ukoliko jedna takva greska je promenjena od suda ili drugog organa za zalbe,
- ukoliko nisu uradili materijalno demantiranje pod bilo kojom svudocenje pod zakletvom, nisu bili u položaju menadzera neke kompanije koja u toku zadnjih godina.

Kandidata koji se izabere kao direktor u Bordu JLP "Tregu" A.D.Gnjilane, ukoliko:

- trenutno je sluzbenik (s hodno clana 21 zakona o JP), mcnadzer doticno preduzece ili bilo koje od njenih filijala,
- je sluzio kao menadzer JP, ili bili njenih filijala u toku pet narednih godina,
- trenutno ima, ili u toku tri prosljih godina imao je bilo koje materijalne poslovne odnose (osim kao individualnog potrosaca sluzbe JP) ili bilo od koje filijale na direktan ili ne direktan nacin, je aksionar, direktor ili sluzbenik ili drugo pravno lice koji ima materijalne poslovne odnose sa doticnim javnim preduzecem,
- prima ili je primio u toku prosljih godina dodatno nakandajivanje od preduzece ili bilo od njenih filijala (osim honorara direktora ili naknadu odredjenom clano 20.1 zakona o JP ili jeplan u semu preduzece ili bilo kojih od njenih filijala,
- predstavlja jednog akcionara, koji poseduje preko 10% akcija u javnim preduzecima,
- je sluzio u bordu direktora vise od devet godina od prvog dana izabranja,
- je blizi trecem stepena (kao sto je konstatovano u skladu sa ogranicenim finansijskim interesu clanu 2 zakona JP), bilo koje osobe koje pripada od gore navedenih kategorija,
- je sluzbenik, direktor ili kacionar ili ima fin.interes u trz.drustvu koja konkurise sa preduzecem, ili je visoki menadzer, sluzbenik, direktor ili aksionar (koji poseduje vise od 2% pravo glasanja) ili ima obimniji fin.interes nilo kojoj od trz.drustva koje konkurisu u preduzeću, je u bilo koje vreme u toku perioda od 36 meseci pre datuma apliciranja, bio je izabran sluzbenik, politicki imenovan ili nosioc rukovodeceg položaja ili odlucivanja u politickoj partiji,
- ima bilo koji konflikt interesa, gde prema prirodni prouzrokovao da ova osoba ne bude u stanju da na efektini nacin, sa posvecenosc , na nezavisan nacin ili ispunjava svoje zadatke prema akcionarima i i JP.

III INFORMACIJA O PROCEDURI KONKURISANJA

Kandidat, za clana Borda direktora u JLP "Tregu" A.D.Gnjilane treba da dostavlja dokumentaciju kao sto sledi dole:

- CV
- Motivacioni papir,
- Dekleraciju pod zakletvom (formular koji se popunjava u trenutku dostavljenje dokumentacije),
- Dokaz strucne spreme,
- Dokaz radnog iskustva,
- Uverenje da nije pod istragom, i
- Izvod rođenih.

Aplikant treba da priprema deklaraciju pod zakletvom u kojoj izjavljuje da on/ona ispunjava uslove kvalifikacije, nezavisnost i strucnu spremu svako materijalno demantiranje namerno ili ne namerno ili materijalnopromenu od datih informacija u gore navedenoj deklaraciji, rezultirace se sa diskvalifikacijom odmah.

Dokumentaciju treba dostaviti u zatvorenoj kovrti i dostavlja se u Centru za Usluge gradjana, bivsi Bankos br.1-Opština Gnjilane.

Dostavljena dokumentacija, kopija ne vraća se dok original može se traziti u toku intervjuisanje.


Kontaktirace se samo izabrani kandidati za intervjuisanje.

Dodatne informacije mozete obezbediti preko brojeve telefona.

Rok je konkursa je otvoren 21 dana od dana objavljivanja u dnevrim novinama, na web.stranici Opštine, na oglasnoj tabli pocevsi od 10.04.2018 do 01.05.2018.god.

Opštinska Komisija Akcionara JLP "Tregu" A.D.Gnjilane
Datum: 10.04.2018





Revistën për kulturë, gjuhë, media, "Akademia", mund ta gjeni në redaksinë e gazetës "Epoka e re", në Sheshin "Edit Durham", 100 metra larg "Grand Hotel"-it. Për informata të tjera mund të thërrisni në këtë numër të telefonit: +377 44 127 434.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Edina Berisha, shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën e gjimnazit "Eqrem Çabej" në Vushtrri.

► Urgjentisht kërkohet një banesë me qira në Fushë Kosovë, për një familje 3 anëtarësh. Banesa duhet të ketë 2 dhoma gjumi, dhomë dite, kuzhinë dhe poashtu të jetë e mobiluar. Banesa kërkohet për afat më të gjatë. Info në tel: 044-741-151

► Urgjentisht kërkohet banesë me qira për një çift në Fushe Kosove. Banesa duhet të ketë një dhomë gjumi dhomë dite me kuzhinë te jete e mobiluar, çmimi: 150-200 euro. Tel 044-741-155

► Epet lokali me qira në rrugën "B" me sipërfaqe prej 214 m2. Lokali është i përshtatshëm për çfarë do lloj veprimtarie. Informatat në tel: 045-660-118.

► Urgjentisht kërkohet banesë me qira në Prishtinë, për një çift me një fëmijë. Banesa duhet të ketë 1 dhomë gjumi dhomë dite me kuzhinë. Po ashtu të jetë e mobiluar si dhe të jetë afatgjatë. Çmimi 200 euro. Tel: 044-741-155

► Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.

► Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.

► Lëshohet me qira banesë tri dhomshe në Bregun e Diellit, mbrapa konvikteve të studentëve, kati VI- lloji funksional, e rinovuar komplet me të gjitha elementet, e mobiluar, ka nxehe qendrore. Banesa lëshohet vetëm për familjar, për banesë duhet të lehet edhe depozitë prej një qeraje. Çmimi 350 euro, tel: 049-400-958

► Agjencia për patundshmëri "SAZANI", kërkohet për blerje dhe lëshojmë me qira: banesa, shtëpi, lokale, troje dhe toka. Ndërmjetësojmë me korrektesë si dhe shesim disa sosh. Numri kontaktues: 044-207-474.

► Shes shtëpinë në rrugën "Haxhi Zeka" afër Shkollës Teknike në Prishtinë. Çmimi sipas marrëveshjes. Tel: 049-909-641.

► Lëshohet banesë me qira në lagjen "Ulpiana" afër AAK-së në Prishtinë. Për informata më të hollësishme lajmërohuni në këtë numër të telefonit: 044-162-783

► Kimete Lanaj B.I. kërkohet një punëkryes për ndërtimin e serrës me sipërfaqe prej 40 ari, me material të zinguar. Oferta zgjat 5 ditë nga dita e shpalljes në gazetë. Kontakti: 044-528-353.

► Lëshohet banesë me qira në lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Kërkohet kamerier me përvojë pune. Gjendemi në Prishtinë te sheshi "Zahir Pajaziti". Nr: kontaktues- 045-999-985.

► Lëshohet banesë me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira kati i parë, në rr. Esat Mekuli, çmimi i volitshëm. Për info. 044/477-107 Prishtinë. Çmimi shumë i volitshëm dhe është e mobiluar komplet.

► Lëshohet banesa me qira në qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

► Lëshohet banesë me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshohet banesë e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049/44-888-801 (viber)

► Lëshohet banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

► Lëshohet banesë një dhomshe me qira, në lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

► Lëshohet me qira banesë e mobiluar te salloni i mobilave "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

► Lëshohet banesë me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.

► Kërkojmë 4 bashkëbanuese, studente, banesa gjendet te Parku i qytetit, kati i l-rë, ka 3 dhoma, banjo, ballkon, çmimi për person është 50 euro plus shpenzimet. Për info: 045/699-221.

► Lëshohet me qira banesa në lagjen Bregu i Diellit te furra Qerimi 2. Banesa është në katin e tretë, ka sallon dhe kuzhinë si dhe dy dhoma të fjetjes. Numri i telefonit: 044 332 640.

URGJENTISHT KËRKOJ BANESË PËR ZYRE ME QIRA

Në qendër të Prishtinës, kërkohet banesë me qira, për zyrë. Hapësira 80-100m2.

Kati i -1- deri në katin -111-
Tel: 044741155

Lajmërohen bashkëpronarët e ngastrës kadastrale P-70202016-0440 bk-O, se bashkëpronari Arif Gërxhaliu ka shprehur dëshirën që të ashës një pjesë të pronës së vet. Andaj njoftohen bashkëpronarët e kësaj parcele kadastrale që nëse janë të interesuar për blerjen e kësaj parcele-pjesën e pronës të lajmërohen te bashkëpronari Arif Gërxhaliu.

LËSHOJ LOKALIN ME QIRA.

Lokali gjendet në rrugën "Isa Kastrati" në Matiqan të Prishtinës dhe ka një hapësirë prej 400 m2. Lokali është i gatshëm dhe shumë funksional. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-509-077.

Urgjentisht kërkohet një shtëpi me qira në Prishtinë. Shtëpia duhet të jetë e veçantë, duhet të ketë 5 ose 6 dhoma gjumi. Çmimi sipas marrëveshjes. Tel 049-472-770



FTESË PËR TENDER

Banka Ekonomike Sh.A. Prishtinë, fton subjektet e interesuara të paraqesin ofertat për:

1. FURNIZIM ME BANKOMATË TË RINJË PËR TËRHEQJE (CASH OUT) DHE BANKOMATË PËR TËRHEQJE DHE DEPONIM (CASH IN)

2. PËRMIRËSIM – (Upgrade) TË BANKOMATËVE EKZISTUES

Për tu kualifikuar kompanitë duhet të dorëzojnë :

- ofertën financiare, çmimet duhet të jenë me TVSH
- specifikacionin detal teknik
- në ofertë duhet të ceket afati i garancionit si dhe afati i liferimit
- dokumentacionin e nevojshëm mbi TVSH-në dhe regjistrimin e biznesit
- referencat - kontratat mbi punë të ngjashme.

Afati i dorëzimit të ofertave është deri më **24 Prill 2018 në ora 15:00.**

Palët e interesuara duhet ta kërkojnë dokumentin e tenderit në Zyrën Qendrore të Bankës Ekonomike në Prishtinë, Sheshi Nëna Terezë p.n. ose përmes kërkesës me shkrim në e-mail adresën: prokurimi@bekonomike.com

Vlefshmëria e ofertës duhet të jetë së paku dy muaj nga data e dorëzimit.


Ofertat në zarf të mbyllur me mbishkrimin "Ofertë për bankomatë" duhet të dorëzohen në lokalet e e Zyrës Qendrore të Bankës Ekonomike në Prishtinë, Sheshi Nëna Terezë p.n. dhe t'i drejtohen Shërbimit të Prokurimit.

Banka Ekonomike mbanë të drejtën të anulojë ose ndryshojë tenderin në cdo kohë.

www.bekonomike.com

Banka Ekonomike Sh.A
Sheshi Nëna Terezë p.n
10000 Prishtinë, Kosovë

info@bekonomike.com
Tel. +383 (0) 38 500 500
Fax. +383 (0) 38 500 507



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

Prishtinë

AUTOSHKOLLA "RITMO - L"

**Auto Shkolla
"RITMO - L"
Prishtinë**

**Eksperiencia jonë
- përfitimi i juaj.**

**Afati i paraqitjes prej 03.03.2018
deri më 10.03.2018**

Ju mirëpret:

Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "

Tel / kontakt:

044 248 173

044 200 604

044 375 333